

RAPORT I VEÇANT

për gjendjet e konstatuara në financimin e
fushatës zgjedhore për zgjedhjen e
kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve
në komunat në Republikën e Maqedonisë së
Veriut për vitin 2025

Përmbajtja

1. HYRJE	1
2. Korniza ligjore	2
3. Kompetencat dhe veprimi i SHPK-së	3
3.1 Aktivitetet para fillimit të fushatës zgjedhore	
• 3.1.1. Bashkëpunimi ndërinstytucional	
• 3.1.2. Njoftime dhe forma tjera për informimin e publikut	
3.2 Aktivitetet gjatë fushatës zgjedhore	
4. TË DHËNA NGA RAPORTET FINANCIARE	8
4.1 Të ardhurat	
• 4.1.1 Shpërndarja e të ardhurave sipas pozicionit politik dhe burimit të financimit	
• 4.1.2. Të ardhura për Reklamim Politik të Paguar (RPP)	
4.2. Shpenzimet	
• 4.2.1. Shpenzimet për reklamim politik të paguar	
5. VENDIME NË KOMPETENCË TË KSHPK	24
5.1. Lëndë sipas denoncimeve/raportimeve	
5.2. Lëndë sipas iniciativës vetjake	
6. RAPORTIMI FINANCIAR	26
6.1. Afatet dhe pikat kritike në raportimin për zgjedhjet lokale	
6.2. Roli mbikëqyrës dhe aktivitetet e KSHPK	
6.3. Gjetjet nga tabela për raportet e dorëzuara dhe llogaritë e mbyllura	
7. DOBËSITË E KODIT ZGJEDHOR	28
8. KONKLuzion	30

1 HYRJE

Çdo cikël zgjedhor paraqet një sfidë të rëndësishme në menaxhimin e burimeve publike dhe aktiviteteve të institucioneve shtetërore. Për të parandaluar korrupsionin dhe keqpërdorimin e mjeteve publike, është thelbësore të zbatohet mbikëqyrje efektive dhe të respektohen në mënyrë rigorozë kufizimet ligjore. Në këtë drejtim, KSHPK-ja ka një rol qendror në sigurimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe transparencës së të gjitha aktiviteteve që zhvillohen gjatë periudhës zgjedhore.

Fushata zgjedhore është një proces që ndikon drejtpërdrejt në shpenzimin e mjeteve nga ana e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore dhe krijon opinionin publik për një kandidat të caktuar te elektorati. Prandaj, ligjshmëria e burimeve të mjeteve për financimin e fushatës dhe ligjshmëria e shpenzimit të tyre janë parakusht themelor për një garë të ndershme politike ndërmjet pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

KSHPK-ja, në përputhje me kompetencat e saj të përcaktuara me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe Kodit Zgjedhor, u angazhua në mënyrë aktive në parandalimin dhe pengimin e korrupsionit gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe anëtarëve të këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2025.

Përmes monitorimit të veprimtarisë financiare të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, KSHPK-ja ndërmerr masa për parandalimin e korrupsionit. Në kreun IV — Parandalimi i korrupsionit në politikë të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, janë të rregulluara procedurat dhe masat që i ndërmerr KSHPK-ja për të parandaluar keqpërdorimet në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore, menaxhimin e të mirave publike dhe mjeteve gjatë procesit zgjedhor. Këto aktivitete fillojnë nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjasin deri në përfundimin e tyre.

KSHPK-ja, në kuadër të kompetencave të saj ligjore, vendosi bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Entin Shtetëror për Revizion, Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shtëpinë e Kliringut – Sistemet ndërbankare të kliringut, si dhe me organe dhe institucione të tjera shtetërore. Ky bashkëpunim ka për synim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e evidencave për të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar në fushatën zgjedhore. Të dhënat e siguruara përdoren në trajtimin e lëndëve që janë në kompetencë të Komisionit. Përmes publikimit të njoftimeve dhe udhëzimeve lidhur me kufizimet ligjore që u referohen të gjitha organeve dhe institucioneve shtetërore gjatë procesit zgjedhor, KSHPK-ja i informon të gjithë subjektet relevante për detyrimet dhe kufizimet ligjore, me qëllim parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme dhe veprimeve korruptive.

Përmes këtyre aktiviteteve, KSHPK-ja siguron që procesi zgjedhor të zhvillohet në mënyrë transparente dhe të ligjshme, duke parandaluar çdo formë korrupsioni dhe keqpërdorimi të mjeteve dhe të mirave publike. Për të arritur cilësi më të lartë, KSHPK bashkëpunoi dhe mori mbështetje nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) dhe nga Shoqata për Hulumtime dhe Analiza – ZMAI. Kontributi dhe ekspertiza e tyre ishin të një rëndësie të veçantë për përgatitjen me sukses të këtij raporti, për çka shprehim mirënjohje të veçantë.

Me rëndësi kyçe është kontributi i KSHPK-së në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në proceset zgjedhore, përmes investimit në sisteme dhe procese që mbrojnë integritetin e institucioneve, sigurojnë përdorim të përgjegjshëm të mjeteve publike dhe promovojnë raportim të besueshëm dhe transparent.

2. Korniza ligjore

Procesi zgjedhor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përfshirë edhe zgjedhjet lokale, mbështetet në parimet kushtetuese dhe në një tërësi ligjesh dhe aktesh nënligjore që së bashku sigurojnë kornizën juridike për organizimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve. Kushtetuta garanton vetëqeverisjen lokale si parim kushtetues dhe përcakton ekzistimin e komunave dhe të Qytetit të Shkupit si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale, ndërsa organizimi territorial dhe çështjet kyçe që lidhen me zgjedhjet lokale dhe financimin lokal rregullohen me ligj. Këto përcaktime kushtetuese e përkufizojnë kornizën në të cilën zhvillohen zgjedhjet lokale dhe theksojnë nevojën për një rregullim juridik të qëndrueshëm, të qartë dhe të zbatueshëm në mënyrë konsistente.

Vetëqeverisja lokale rregullohet më tej përmes ligjeve sistemore, ndër të cilat Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Organizimin Territorial të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ligji për Qytetin e Shkupit. Edhe pse këto ligje nuk e rregullojnë drejtpërdrejt rrjedhën e procedurës zgjedhore, ato kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për zgjedhjet lokale, sepse rregullojnë shtrirjen dhe organizimin e komunave, statusin e veçantë të Qytetit të Shkupit, numrin e anëtarëve në këshilla dhe disa aspekte të funksionimit lokal që janë relevante për kontekstin zgjedhor.

Akti kryesor ligjor për zgjedhjet lokale është Kodi Zgjedhor, i cili i përcakton rregullat dhe procedurat për zgjedhjen e kryetarit të komunës dhe të anëtarëve të këshillave të komunave dhe të Këshillit të Qytetit të Shkupit, si dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor: evidentimin e së drejtës së votës, mbajtjen e Listës së zgjedhësve, përcaktimin dhe publikimin e vendeve të votimit, procedurat për kandidatura dhe lista zgjedhore, rrjedhën e fushatës zgjedhore, zhvillimin e votimit, përcaktimin e rezultateve dhe trajtimin e ankesave dhe kontesteve zgjedhore. Kodi gjithashtu vendos rregulla për fushatën zgjedhore dhe kufizime që kanë për qëllim mbrojtjen e integritetit të procesit dhe zvogëlimin e mundësisë për keqpërdorimin e burimeve publike ose trajtim të pabarabartë të pjesëmarrësve.

Aktet nënligjore të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) e operacionalizojnë kornizën ligjore përmes udhëzimeve, rregulloreve dhe vendimeve me të cilat përcaktohen aspektet teknike dhe organizative të zgjedhjeve. Këto akte janë të rëndësishme për zbatimin praktik të Kodit Zgjedhor, sepse sigurojnë një qasje të unifikuar gjatë zbatimit të veprimeve zgjedhore dhe mundësojnë parashikueshmëri dhe siguri juridike për pjesëmarrësit dhe institucionet.

Kompetencat e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në lidhje me parandalimin e korrupsionit në politikë dhe mbrojtjen e interesit publik gjatë zgjedhjeve përcaktohen me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe me Kodin Zgjedhor. Dispozitat ligjore e pozicionojnë KSHPK-në si një mekanizëm kyç parandalues dhe mbikëqyrës në procesin zgjedhor, përmes monitorimit të ligjshmërisë në financimin e fushatës zgjedhore, ndjekjes së rreziqeve për keqpërdorim të mjeteve dhe burimeve publike, veprimit mbi bazë të denoncimeve dhe ankesave të paraqitura, trajtimin të lëndëve të hapura me iniciativë vetjake, si dhe inicimit të masave para organeve kompetente kur ekzistojnë baza për dyshime për shkelje të ligjit.

Kodi Penal e plotëson kornizën juridike përmes inkriminimit të veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimit, përfshirë veprat që lidhen me ryshfetin, cenimin e së drejtës së votës, mashtrimin zgjedhor dhe keqpërdorimin e mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore. Ekzistimi i mbrojtjes penalo-juridike është i rëndësishëm sepse siguron një efekt shtesë në parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe një bazë për veprim kur konstatohen forma më të rënda të parregullsive. KSHPK-ja i ushtron kompetencat e saj për monitorimin e aktiviteteve të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, me qëllim sigurimin e ligjshmërisë, transparencës dhe integritetit të procesit zgjedhor.

3. Kompetencat dhe veprimi i SHPK-së

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) ka një rol aktiv në monitorimin e keqpërdorimit të mundshëm të mjeteve buxhetore gjatë zgjedhjeve. Kompetencat e Komisionit realizohen përmes aktiviteteve parandaluese, monitoruese dhe mbikëqyrëse që zbatohen në mënyrë të vazhdueshme, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre.

Kompetencat dhe veprimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit rregullohen me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, përkatësisht në Kreun IV – Parandalimi i korrupsionit në politikë, në nenet nga 32 deri në 37. Sipas këtyre dispozitave, KSHPK-ja e monitoron ligjshmërinë e financimit të fushatave zgjedhore, ndjek ligjshmërinë e përdorimit dhe disponimit me mjetet buxhetore, vepron në rast dyshimi për mosrespektim të ndalimit për investime të reja dhe pagesa të jashtëzakonshme, si dhe ndalimin e përdorimit të burimeve të paligjshme dhe anonime të financimit gjatë zgjedhjeve, si dhe konstaton keqpërdorim të financimit të partive politike gjatë fushatës zgjedhore ose ryshfet ndaj votuesve.

Në drejtim të realizimit të rolit të saj parandalues, në fillim të periudhës zgjedhore KSHPK publikon një njoftim me të cilin informon organet shtetërore dhe bartësit e autorizimeve publike lidhur me kufizimet ligjore që vlejné gjatë periudhës zgjedhore. Përmes njoftimeve, udhëzimeve dhe komunikimit me institucionet, KSHPK-ja kontribuon në informimin me kohë për ndalimet dhe detyrimet, si dhe në reduktimin e rrezikut nga shkeljet. Veprimi parandalues ka për qëllim krijimin e një kufiri të qartë ndërmjet funksionimit të rregullt institucional dhe garës zgjedhore, me theks të veçantë mbi rreziqet nga keqpërdorimi i burimeve publike dhe nga ndikimi në proceset administrative gjatë një periudhe senzitive.

Komisioni, njëkohësisht, e ndjek në mënyrë pro aktive procesin zgjedhor përmes mobilizimit të burimeve të veta institucionale dhe njerëzore, si dhe përmes vendosjes së bashkëpunimit me institucione dhe organe relevante për sigurimin e të dhënave dhe informacioneve. KSHPK-ja i analizon raportet financiare të paraqitura nga pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, si dhe të dhëna të tjera relevante, me qëllim të përcaktimit nëse financimi dhe shpenzimi i mjeteve zhvillohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Në këtë pjesë, Komisioni e përqendron vëmendjen në ligjshmërinë e burimeve të financimit, përputhshmërinë e donacioneve me kufijtë dhe rregullat e lejuara, afatin dhe saktësinë e raportimit financiar dhe transparencën e të dhënave të publikuara.

Për më tepër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka obligim të monitorojë edhe rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në Ligjin për Financimin e Partive Politike. Këto ligje e rregullojnë mënyrën e veprimit të institucioneve shtetërore dhe komunale gjatë periudhës zgjedhore, rregullat për financimin e pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore, mënyrën e zhvillimit të fushatave zgjedhore, si dhe transparencën, llogaridhënien dhe financimin e partive politike, brenda dhe jashtë fushatës zgjedhore.

KSHPK-ja vepron mbi bazë të denoncimeve/raportimeve nga qytetarë ose persona juridikë, ose hap lëndë me iniciativë vetjake kur nga informacionet publike, publikimet në media ose burime të tjera rezultojné dyshime për shkelje të dispozitave ligjore. Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe përcaktimit të gjendjes faktike, KSHPK-ja fillon një procedurë në kuadër të së cilës verifikon dyshimet përmes grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve nga institucione të tjera. Pas përpunimit të të dhënave, në seancë publike merr vendime për lëndë konkrete. Në rastet kur

ekzistojnë baza për dyshim për shkelje të dispozitave ligjore, Komisioni u adreson iniciativa organeve kompetente shtetërore për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse.

Kjo qasje siguron një lidhje funksionale ndërmjet parandalimit dhe veprimit, duke mundësuar reagim në kohë kur ekziston rrezik për cenimin e ligjshmërisë dhe integritetit të procesit zgjedhor.

Monitorimi i ligjshmërisë së financimit zbatohet në mënyrë të vazhdueshme dhe në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, me theks të veçantë në kontrollin e financimit të fushatave zgjedhore, parandalimin e keqpërdorimit të mjeteve buxhetore, respektimin e ndalimit për investime të reja publike dhe pagesa të jashtëzakonshme, si dhe parandalimin e përdorimit të burimeve të paligjshme të financimit. Këto aktivitete përbëjnë një mekanizëm kyç për mbrojtjen e interesit publik dhe ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

Një segment veçanërisht i rëndësishëm i punës së KSHPK-së gjatë periudhës zgjedhore është sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies. Komisioni, në kuadër të kompetencave të tij, kontribuon në informimin publik për aspektet kryesore të procesit zgjedhor që lidhen me rreziqet nga korrupsioni dhe keqpërdorimi i burimeve, si dhe me raportimin financiar. Veprimi transparent dhe vënia në dukje të dobësive dhe sfidave sistemore kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin e besimit në mbikëqyrjen institucionale dhe në inkurajimin e publikut për të denoncuar parregullsi.

Fushëveprimi i analizës së KSHPK-së përfshin:

- **analizën e llojeve të burimeve të financimit** – me qëllim të përcaktimit të ligjshmërisë dhe transparencës së tyre, si dhe përputhshmërisë me kornizën ligjore në fuqi;
- **verifikimin e shumës së donacioneve** – monitorimin dhe kontrollin e shumave individuale dhe totale të donacioneve, me fokus të veçantë mbi respektimin e kufijve ligjorë dhe financimin e palejuar;
- **monitorimin e ligjshmërisë së përdorimit, përkatësisht dispozicionit të mjeteve buxhetore** – ndjekjen e përdorimit të mjeteve publike, përkatësisht buxhetore, gjatë fushatës zgjedhore, me qëllim të përcaktimit nëse ato janë përdorur në përputhje me ligjin, qëllimin e tyre dhe parimet e menaxhimit racional të financave publike;
- **kontrollin e shpenzimeve gjatë fushatës zgjedhore** – verifikimin e shpenzimeve të përgjithshme të krijuara gjatë fushatës zgjedhore, strukturën e tyre dhe përputhshmërinë me kufizimet ligjore dhe kategoritë e lejuara të shpenzimeve;
- **verifikimin e afateve ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve financiare** – ndjekjen nëse raportet financiare për të ardhurat dhe shpenzimet në llogarinë e fushatës zgjedhore janë përgatitur me kohë, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj dhe me formularët e parashikuar, si dhe dorëzimin e tyre në KSHPK;

Në kuadër të çdo procesi zgjedhor, KSHPK-ja në mënyrë plotësuese e monitoron përmbushjen e detyrimeve të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor që lidhen me regjistrimin e tyre, përmes sigurimit të të dhënave nga organet kompetente, si dhe evidentimin dhe paraqitjen e rregullt dhe të ligjshme të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhen me fushatën zgjedhore.

Përveç kompetencave të përcaktuara, Komisioni përballet edhe me kufizime praktike që burojnë nga vakumet ligjore dhe nga zgjidhjet normative pamjaftueshëm të sakta ose pamjaftueshëm të zbatueshme në mënyrë konsistente. Në disa situata ekzistojnë rrethana vështirësuese në sigurimin e informacioneve të plota dhe në kohë nga institucionet, ose mungojnë mekanizma të përshtatshëm kundërvajtës për mosveprim sipas detyrimeve ligjore, gjë që e kufizon efikasitetin e mbikëqyrjes. Këto sfida e theksojnë nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të kornizës ligjore dhe institucionale, me qëllim që të sigurohet parandalimi më efektiv i keqpërdorimeve dhe integritet më i fortë i procesit zgjedhor.

Në përputhje me nenin 32 të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, KSHPK-ja përgatit Raport të veçantë për gjendjet e konstatuara në financimin e fushatës zgjedhore, në të cilin paraqiten gjetjet dhe jepen rekomandime për tejkalimin e dobësive të evidentuara. Ky Raport i dërgohet Kuvendit të RMV-së, brenda afatit prej tre muajsh nga dita e përfundimit të zgjedhjeve.

3.1 Aktivitetet para fillimit të fushatës zgjedhore

Në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe në Kodin Zgjedhor parashihen kompetencat, aktivitetet dhe afatet për veprim të KSHPK-së në lidhje me monitorimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Kuvendi i RMV-së më 9.8.2025 miratoi Aktvendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarët e këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit, si dhe për kryetarët e komunave dhe kryetarin e Qytetit të Shkupit, me numër 09-4408/1 nga data 9.8.2025, ku në nenin 2 është përcaktuar se: „Zgjedhjet do të mbahen më 19 tetor 2025“. Pas publikimit të aktvendimit, KSHPK-ja ndërmerr veprime me qëllim organizimin e burimeve në dispozicion (njerëzore, teknike), për të vendosur monitorim efikas mbi ligjshmërinë e financimit të fushatës zgjedhore.

3.1.1. Bashkëpunimi ndërinstitucional

Me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në pjesën e veprimit të institucioneve për Zgjedhjet lokale 2025, veçanërisht me institucionet kompetencat e të cilave përfshijnë veprim gjatë procesit zgjedhor, u organizuan disa takime pune, si vijon:

- **takim pune me kryetarin dhe me një pjesë të anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve**, në prani të përfaqësuesve të Misionit të OSBE-së në Shkup, i cili iu kushtua thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Takimi kishte fokus të veçantë mbi çështjet që lidhen me integritetin e procesit zgjedhor, si dhe mbi përcaktimin e nevojës për formalizmin e koordinimit të ndërsjellë përmes lidhjes së Memorandumit për Bashkëpunim, me qëllim krijimin e kushteve për veprim të shpejtë dhe të harmonizuar në rastet e konfliktit të mundshëm të interesit dhe situatave të tjera që kërkojnë vlerësim urgjent dhe reagim institucional.
- **takim pune me Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut**, me kryetarin e komisionit të përkohshëm në Prokurorinë publike për monitorimin e parregullsive të mundshme zgjedhore dhe me prokurorë publik në PPRMV-së, ku u shkëmbyen informacione për përbërjen, kompetencat dhe aktivitetet e komisionit të përkohshëm të ngarkuar për të monitoruar veprimin lidhur me parregullsitë e mundshme zgjedhore që lidhen me ekzistimin e veprave penale nga kapitulli 16 i Kodit Penal – vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit, si dhe vepra të tjera penale që mund të kryhen gjatë organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve. Në këtë takim u theksua nga të dyja palët gatishmëria për bashkëpunim të dy institucioneve gjatë procesit zgjedhor.
- **u nënshkrua Memorandum Bashkëpunimi** ndërmjet **Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Entit Shtetëror për Revizion**. Me këtë memorandum, tre institucionet e forcojnë përkushtimin e tyre për bashkëpunim të drejtpërdrejtë, koordinim dhe ndihmë të ndërsjellë gjatë zbatimit të dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore, shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave, si dhe veprimin në kohë ndaj parregullsive të konstatuara, veçanërisht në pjesën e veprimit sipas parashtrësive, kundërshtimeve dhe procedurave të tjera me interes të përbashkët.
- **takim pune me përfaqësues të Misionit Vëzhgues të OSBE-së**, në të cilin u prezantuan kompetencat ligjore dhe roli i KSHPK-së në procesin zgjedhor.

Veç tjerash u arsyetuan edhe aktivitetet aktuale dhe të planifikuara të KSHPK-së për monitorimin e procesit zgjedhor, me qëllim sigurimin e përdorimit transparent dhe të ligjshëm të të mirave publike dhe të shpenzimit të mjeteve buxhetore, si dhe sfidat me të cilat përballlet KSHPK-ja në monitorimin e procesit zgjedhor, dobësitë sistemike dhe paqartësitë ligjore në legjislacionin zgjedhor. Në këtë takim u dakordësua bashkëpunimi i ndërsjellë dhe komunikimi intensiv gjatë gjithë procesit zgjedhor.

3.1.2. Njoftime dhe forma tjera për informimin e publikut

Me qëllim informimin e publikut lidhur me kufizimet dhe aktivitetet ligjore që vlejné gjatë procesit zgjedhor, si dhe për të mundësuar raportim më të lehtë të dyshimeve për parregullsitë gjatë procesit zgjedhor, KSHPK-ja në faqen e saj të internetit publikoi disa njoftime dhe vuri në dispozicion disa instrumente për paraqitjen më të lehtë të denoncimeve nga qytetarët lidhur me dyshimet për parregullsitë zgjedhore, si vijon:

- **formulari** – Denoncim për dyshime në lidhje me paligjshmëritë dhe shkeljet në procesin zgjedhor si dhe në fushatën zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025, përmes të cilit çdo palë e interesuar në RMV mund të denonconte shkelje zgjedhore gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor;
- **njoftim me qëllim të informimit në kohë dhe transparent të organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal, dhe të organeve tjera shtetërore**, si dhe të publikut, lidhur me ligjshmërinë e përdorimit dhe dispozicionit të mjeteve buxhetore nga dita e shpalljes së Zgjedhjeve lokale 2025, në lidhje me kompetencat dhe detyrimet, përkatësisht detyrimet e përcaktuara me nenin 34 dhe 36 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, si dhe me nenet 8-a dhe 8-b të Kodit Zgjedhor, sipas të cilave personat përgjegjës në fondet, agjencitë, drejtoritë, ndërmarrjet publike, organet rregullatore, shoqëritë tregtare të themeluara nga shteti dhe institucione tjera të themeluara nga shteti, si dhe partitë politike dhe pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, janë të detyruar të respektojnë kufizimet ligjore gjatë procesit zgjedhor.
- **u vu në dispozicion ueb-aplikacioni** – Regjistri i automjeteve të organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridikë që kanë në dispozicion kapital shtetëror, me qëllim raportimin e përdorimit të palejuar të automjeteve zyrtare për qëllime zgjedhore, bashkëngjitur formularin – Tabelë për dërgimin e të dhënave për automjetet me të dhëna të plotësuar, të cilat duhej të dërgoheshin në adresën elektronike të KSHPK-së.

3.2 Aktivitetet gjatë fushatës zgjedhore

Në kuadër të veprimit të saj gjatë periudhës zgjedhore, si edhe në ciklet e kaluara zgjedhore, KSHPK-ja njoftoi se nuk ka kompetencë ligjore të japë mendim në lidhje me zbatimin e dispozitave të nenit 8-a dhe 8-b dhe nenit 34 të LPKKI. Megjithatë, pavarësisht këtyre sqarimeve, gjatë kësaj periudhe zgjedhore në KSHPK nga organet shtetërore, personat juridikë të themeluar nga shteti dhe persona fizikë u dorëzuan gjithsej 246 (dyqind e dyzet e gjashtë) kërkesa për mendim që kishin të bënin me çështje për ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete, në kuptim të respektimit të ndalimeve të përcaktuara me nenin 8-a dhe nenin 8-b të Kodit Zgjedhor dhe nenin 34 të LPKKI. Për të gjitha këto kërkesa u dërgua njoftim se Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka bazë ligjore dhe kompetencë të japë mendim ose pëlqim për kërkesat e dorëzuara për mendim, duke theksuar se gjatë vendimmarrjes për mos/zbatim të aktiviteteve të caktuara, nga dita e miratimit të vendimeve për shpalljen e zgjedhjeve e deri në përfundimin e zgjedhjeve lokale, është


e nevojshme të respektohen ndalimet e përcaktuara në nenin 8-a dhe 8-b të Kodit Zgjedhor dhe nenin 34 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe se ato janë përgjegjësi të personave përgjegjës në organet shtetërore dhe subjektet e tjera.

Sipas nenit 8-b, paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor, fondet publike, ndërmarrjet publike dhe të gjithë personat e tjerë juridikë që disponojnë kapital shtetëror kanë detyrim që brenda dhjetë ditëve nga miratimi i vendimit për shpalljen e zgjedhjeve të dorëzojnë të dhëna në KSHPK për numrin, llojin, targat dhe gjendjen e automjeteve zyrtare me të cilat disponojnë.

Sipas nenit 8-b, paragrafi 5 të Kodit Zgjedhor, nëse subjektet nuk i dërgojnë të dhënat e kërkuara, KSHPK është e detyruar të iniciojë procedurë për kundërvajtje brenda 15 ditëve pas skadimit të afatit për dërgimin e të dhënave. Megjithatë, për shkak të vakumit juridik në Kodin Zgjedhor ku nuk janë paraparë sanksione për kundërvajtje, KSHPK nuk ka mundësi të iniciojë procedura për kundërvajtje mbi këtë bazë. Duke e pasur parasysh gjendjen e mungesës së një zgjidhjeje normative për sanksionim, KSHPK, me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të automjeteve zyrtare për nevojat e fushatës zgjedhore, dërgoi njoftim në Ministrinë e Punëve të Brendshme me kërkesë për sigurimin e të dhënave për të gjitha automjetet zyrtare që përdoren nga institucionet shtetërore. Ministria e punëve të brendshme iu përgjigj kërkesës, duke siguruar të dhëna për 1 557 institucione. Nga ana tjetër, KSHPK u dërgoi njoftime organeve që i emërojnë dhe zgjedhin drejtuesit, përkatësisht Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut (BNJVL), me të dhëna për institucionet që nuk i kanë dërguar të dhënat e nevojshme.

Meqë një numër i vogël institucionesh dhe organesh shtetërore iu përgjigjën kërkesës për përditësimin e të dhënave nga Regjistri i automjeteve, Komisioni i publikoi në mënyrë transparente të gjitha institucionet që nuk kanë dërguar informacione brenda afatit ligjor.

Grafiku 1 Numri i të dhënave të pranura për automjetet zyrtare në krahasim me Regjistrin e automjeteve të MPB



Burimi: Të dhënat administrative të KSHPK

4. TË DHËNA NGA RAPORTET FINANCIARE

4.1 Të ardhurat

Në kontekst të zbatimit të zgjedhjeve lokale, KSHPK-ja ushtron në mënyrë aktive kompetencën e saj në drejtim të sigurimit të integritetit dhe ligjshmërisë në financimin e fushatës zgjedhore. Komisioni në veçanti monitoron mënyrën e sigurimit, evidentimit dhe përdorimit të mjeteve nga ana e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.


Sipas nenit 83 të Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore mund të financohet përmes mjeteve të transferuara nga llogaria e rregullt e partisë politike, përmes pagesave të anëtarësisë, donacioneve nga persona fizikë dhe juridikë, si dhe përmes kredive për fushatën zgjedhore. Në fushatë mund të pranohen donacione në para, sende dhe shërbime edhe nga: persona fizikë deri në 3.000 euro në kundërvlerë në denarë, si dhe nga persona juridikë deri në 30.000 euro në kundërvlerë në denarë. Të gjitha donacionet duhet të paguhen në një llogari të veçantë transaksioni, të evidentohen (regjistri i donacioneve) dhe nëse shuma e tejkalon limitin e lejuar, diferenca detyrimisht transferohet në buxhetin e shtetit. Këto kufizime duhet të respektohen nga të gjithë pjesëmarrësit në fushatë.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, KSHPK ka rol aktiv në mbikëqyrjen e këtyre proceseve, veçanërisht në drejtim të sigurimit të transparencës së burimeve të financimit dhe përcaktimit të përputhshmërisë së tyre me kufizimet ligjore. Komisioni zhvillon procedura për verifikimin dhe analizën e të dhënave nga raportet financiare dhe ekstraktet bankare për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.

Në përputhje me dispozitat ligjore që lidhen me financimin e reklamimit politik me pagesë në media gjatë fushatës zgjedhore, mjetet për këtë qëllim sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe paguhen përmes Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). KSHPK monitoron shpërndarjen dhe pagesën e këtyre mjeteve në bazë të të dhënave të përfshira në raportet financiare dhe në bazë të të dhënave të dërguara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Analiza e raporteve që iu dërguan KSHPK-së nga pjesëmarrësit në procesin zgjedhor vë në dukje se struktura e të ardhurave për fushatën zgjedhore është e përbërë në mënyrë dominuese nga mjetet për reklamim politik me pagesë (RPP) dhe nga transferimet e mjeteve nga llogaritë bazë të transaksionit të partive politike drejt llogarive për fushatën zgjedhore. Sipas të dhënave të dërguara, kategoria më e madhe individuale është RPP në shumën prej 284.156.613 denarësh, që përfaqëson 47,6 % të të ardhurave totale të evidentuara. Njëherësh, transferimet nga llogaritë bazë të partive arrijnë gjithsej në 305.256.790 denarë (51,1 %), prej të cilave 190.902.831 denarë janë evidentuar si mjete të transferuara nga donacione të personave juridikë, ndërsa 114.353.959 denarë si mjete të transferuara nga donacione të personave fizik.

Të ardhurat e raportuara drejtpërdrejt në llogaritë zgjedhore në kategorinë “donacione në para, sende dhe shërbime” janë dukshëm më të vogla dhe arrijnë gjithsej në 7.930.272 denarë (1,3 %), përkatësisht 2.756.650 denarë nga persona juridikë dhe 5.173.622 denarë nga persona fizik. Shuma totale e të ardhurave e përfshirë në këtë strukturë arrin në 597.343.675 denarë. Në grafikun në vijim paraqitet struktura e përgjithshme e të ardhurave sipas burimit, duke pasur parasysh se një pjesë e mjeteve janë evidentuar si transferime nga llogaritë bazë të partive, ndërsa një pjesë si të ardhura të raportuara drejtpërdrejt në llogaritë për fushatën zgjedhore.

Grafiku 2 Shuma në total e të ardhurave sipas burimit




Burimi: të dhënat administrative të KSHPK-së nga raportet e përgjithshme financiare

Analiza sipas burimeve kryesore të të ardhurave vë në dukje se pjesa më e madhe e donacioneve nuk hyjnë drejtpërdrejt në llogaritë për fushatën zgjedhore, por paraprakisht akumulohen në llogaritë bazë të subjekteve politike dhe më pas transferohen. Mjetet totale (pa RPP dhe pa mjete nga buxheti) arrijnë në 147.204.675 denarë, prej të cilave deri më 139.251.403 denarë, përkatësisht 94,6 %, janë donacione të pranuar në llogarinë bazë. Kjo tregon një dominim të fortë të modelit të ndërmjetëm të financimit përmes funksionimit të rregullt financiar të partive, në vend të donacioneve direkte në llogarinë zgjedhore.

Brenda kornizave të këtyre donacioneve të transferuara nga llogaritë bazë, shuma më e madhe i përket donacioneve nga persona fizik në vlerë prej 114.330.959 denarësh, ndërsa donacionet nga persona juridik arrijnë në 24.920.444 denarë. Donacionet direkte në llogaritë për fushatën zgjedhore (në para, gjëra dhe shërbime) kanë një vëllim dukshëm më të vogël dhe arrijnë gjithsej në 7.953.272 denarë, përkatësisht vetëm 5,4 % të mjeteve totale. Prej tyre, pjesa më e madhe janë donacione monetare nga persona fizik (4.952.032 denarë) dhe donacione monetare nga persona juridik (2.417.500 denarë), ndërsa donacionet në shërbime ose gjëra mbeten marginale: 339.150 denarë nga persona juridik dhe 244.590 denarë nga persona fizik. Kjo e konfirmon konstatimin se donacionet jomonetare, edhe pse formalisht të pranishme në sistem, kanë rëndësi praktike të kufizuar në strukturën e përgjithshme të financimit.

Në strukturën e përgjithshme të të gjitha të ardhurave të evidentuara, RPP (284.156.613 denarë) dhe mjetet nga buxheti (165.982.387 denarë) së bashku arrijnë në 450.139.000 denarë, përkatësisht rreth 75,4 % të të gjitha të ardhurave. Kjo konfirmon më tej se, përveç rëndësisë së donacioneve private, kapaciteti dominues financiar i fushatave vazhdon të jetë i përqendruar në burimet publike në lidhje me procesin zgjedhor, ndërsa donacionet private kanë një rol plotësues, dhe jo primar, në financimin e pjesës më të madhe të pjesëmarrësve.

Grafiku 3 Shuma totale e të ardhurave sipas nëntipit të burimit



Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK-së nga raportet e përgjithshme financiare

Në kuadër të analizës së realizuar për të ardhurat e pjesëmarrësve në zgjedhjet lokale të vitit 2025, të dhënat e marra nga raportet financiare të dërguara dhe nga transaksionet bankare të regjistruara vënë në dukje ekzistimin e dallimeve të konsiderueshme që rrjedhin nga përmbushja jo e plotë e detyrimit për dorgimin e raporteve të përgjithshme financiare nga ana e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor (vetëm 46 % e pjesëmarrësve kanë dorëzuar raport të përgjithshëm financiar për fushatën zgjedhore). Sipas raporteve financiare të dërguara nga partitë politike, koalicionet dhe grupet e zgjedhësve, gjithsej janë evidentuar të ardhura në shumën prej 594.082.033 denarësh. Megjithatë, analiza e të dhënave nga ekstraktet bankare tregon se në llogaritë e transaksionit të dedikuara për fushatën zgjedhore janë realizuar të hyra totale në shumën prej 596.864.905 denarësh. Kjo shifër i përfshin të gjitha transaksionet e identifikuar, pavarësisht nëse është dërguar raport i përgjithshëm financiar dhe nëse llogaria është mbyllur brenda afatit të paraparë me ligj. Dallimi është relativisht i ulët (2.782.872 denarë), veçanërisht duke e pasur parasysh se pjesëmarrësit që nuk kanë dërguar raporte të përgjithshme financiare kanë realizuar donacione të vogla dhe të papërfillshme. Shuma e mjeteve është marrë nga përpunimi i 77 raporteve të përgjithshme financiare që janë dërguar në KSHPK nga pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Në procesin zgjedhor morën pjesë gjithsej 166 pjesëmarrës[1], ndërsa u përpunuan edhe llogaritë e tyre të hapura bankare zgjedhore, në të cilat KSHPK-ja siguroi qasje në përputhje me nenin 71 paragrafin 13 të Kodit Zgjedhor. Gjithsej 89 pjesëmarrës në fushatën zgjedhore nuk kanë dërguar raport final për fushatën zgjedhore në KSHPK, që përbën 54 % të të gjithë pjesëmarrësve. Pikërisht ky dallim vë në dukje nevojën për digjitalizimin e procesit të mbajtjes dhe përgatitjes së raporteve të nevojshme dhe për tejkalimin e dobësive sistemore në pjesën e sanksionimit për mosrespektimin e ligjit.

[1] Burimi: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve - Raporti Përfundimtar mbi Zgjedhjet e Zbatuara për Anëtarë të Këshillave Komunale dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe Kryetarë të Bashkive dhe Kryetarit të Qytetit të Shkupit, 2025

Këto të dhëna konfirmojnë se gjatë procesit zgjedhor ekziston një rrezik sistemor nga raportimi jo i plotë i burimeve dhe i vëllimit të financimit, veçanërisht kur jo të gjithë pjesëmarrësit veprojnë në përputhje me detyrimet ligjore. Një gjendje e tillë e vështirëson vlerësimin e ndikimit të burimeve të ndryshme të financimit mbi integritetin zgjedhor dhe krijon kushte për keqpërdorime të mundshme dhe për fshehjen e shpenzimeve reale. Komisioni e njih nevojën për avancimin e mekanizmave të kontrollit dhe për vendosjen e sanksioneve për mosdërgimin e raporteve, me qëllim që të mundësohet transparencë e plotë dhe në kohë e financave për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.

Tabela 1: Shuma totale e të ardhurave sipas burimit dhe llojit të pjesëmarrësit

Lloji i pjesëmarrësit	DONACIONE NGA PERSONA JURIDIK NGA LLOGARIA BAZË	DONACIONE NGA PERSONA FIZIK NGA LLOGARIA BAZË	RPP	DONACIONE NGA PERSONA JURIDIK (NË PARA, SENDE DHE SHËRBIME)	DONACIONE NGA PERSONA FIZIK (PARA, SENDE DHE SHËRBIME)	GJITHSEJ
Koalicione	163.845.208	114.353.959	277.394.594	153.000	2.621.000	558.367.761
Parti politike	27.057.623		6.486.692	186.565	854.555	34.585.435
Kandidatë të pavarur të mbështetur nga grup votuesish			275.327	2.417.085	1.698.067	4.390.479
GJITHSEJ	190.902.831	114.353.959	284.156.613	2.756.650	5.173.622	597.343.675

Burimi: Të dhënat administrative të SCPC nga pasqyrat financiare të përgjithshme

Analiza e të ardhurave sipas llojit të pjesëmarrësve në zgjedhjet lokale të vitit 2025, bazuar në raportet financiare të dorëzuara, tregon një përqendrim të konsiderueshëm të mjeteve tek koalicionet, ndërsa partitë politike dhe grupet e votuesve raportojnë shuma dukshëm më të vogla të mjeteve të përgjithshme të disponueshme për financimin e fushatave. Koalicionet kanë raportuar gjithsej 116.974.959 denarë si donacione nga personat fizikë, që përbën 98% të donacioneve totale nga ky burim, si dhe donacione nga persona juridikë në shumën totale prej 163.998.208 denarësh. Përveç kësaj, nga këto mjete koalicionet kanë transferuar gjithsej 278.199.167 denarë nga llogaritë e tyre të rregullta. Ata kanë raportuar 277.394.594 denarë për reklamim politik të paguar.

Pjesëmarrja e pavarur e partive politike në këto zgjedhje lokale ishte e pakonsiderueshme. Njëherësh, ato kanë raportuar një vëllim të ulët të mjeteve financiare. Pjesa më e madhe e të ardhurave të tyre vjen në formë donacionesh nga persona juridik (27.244.188 denarë), nga të cilat 99,5% janë regjistruar si transferim i mjeteve nga llogaritë e rregullta. Donacionet nga persona fizik tek partitë politike janë relativisht të ulëta (854.555 denarë), ndërsa shuma e paguar për reklamim politik arrin vetëm 6.486.692 denarë.

Grupet e votuesve, të cilat në këto zgjedhje përbënin kategorinë më të madhe të pjesëmarrësve me gjithsej 120 pjesëmarrës, kanë raportuar 2.417.085 denarë si donacione nga persona juridik dhe 1.698.067 denarë nga persona fizik. Në përgjithësi, analiza tregon se koalicionet disponojnë pjesën më të madhe të mjeteve të disponueshme në fushatë, gjë që është veçanërisht e dukshme në kategoritë që lidhen me reklamimin politik të paguar dhe donacionet nga personat fizik. Të ardhurat totale të raportuara nga të gjitha burimet arrijnë në 683 milionë denarë.

Analiza e të ardhurave nga fushata zgjedhore sipas statusit politik të pjesëmarrësve (pushtet/opozitë) dhe përfshirjes së tyre në koalicione tregon dallime të konsiderueshme në qasjen ndaj burimeve financiare, në strukturën e të ardhurave dhe në shkallën e mobilizimit të mjeteve financiare.

Subjektet politike që janë në pushtet në momentin e zgjedhjeve kanë **raportuar 287,1 milionë denarë** si të ardhura për financimin e fushatës, që përbëjnë **48% të mjeteve totale** (597 milionë denarë). Nga ana tjetër, subjektet që konsiderohen si parti opozitare, por që janë parti parlamentare, kanë raportuar **293 milionë denarë**, ose **49% të shumës totale**, ndërsa pjesa e mbetur i përket subjekteve më të vogla, të pavarura ose joparlamentare.

Pjesa më e madhe e mjeteve të të gjithë pjesëmarrësit, pa marrë parasysh pozicionin politik, lidhet me **mjetet vetjake të transferuara dhe RPP**, me ç'rast:

- Partitë në pushtet dominojnë në donacionet nga personat fizik, veçanërisht përmes transferimit të mjeteve nga llogaritë e rregullta (shembull: koalicionet e udhëhequra nga VMRO-DPMNE me 133,8 milionë denarë).
- Partitë opozitare tregojnë një model të ngjashëm – koalicionet e udhëhequra nga LSDM dhe Koalicioni AKI kanë një pjesëmarrje pothuajse të barabartë të burimeve të veta dhe të reklamimit, por me një vëllim më të kufizuar.
- Subjektet e pavarura ose ato jashtë parlamentit paraqesin shuma dukshëm më të vogla në total dhe kryesisht varen nga donacionet minimale dhe nga shuma modeste për reklamim mediatik.

Shuma e të ardhurave të siguruara për financimin e fushatës zgjedhore sipas pjesëmarrësve në të paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela 2: Shuma totale e të ardhurave sipas pozitës së pjesëmarrësit dhe burimit të financimit

LLOJI I PJESËMARRËSIT	Pjesëmarrësi / lloji i të ardhurave	Shuma e të ardhurave
PUSHTETI		287.127.218
	Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	220.499.682
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	7.341.000
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat fizik	113.861.509
	RPP	99.297.173
	Lëvizja ZNAM PËR MAQEDONINË TONË	10.050.686
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	10.050.686
	Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni – Bratska	5.010.186
	Donacion në para nga persona fizik	110.700
	RPP	4.899.486
	ALEANCA DEMOKRATIKE	94.018
	Donacion në para nga persona fizik	40
	RPP	93.978
	Koalicioni VLEN	51.472.646
	Donacion në para nga persona fizik	2.020.000
	Donacion në shërbime ose sende nga personat juridik	60.000
	RPP	44.694.646
	Mjete nga buxheti	4.698.000

Tabela 2: Shuma totale e të ardhurave sipas pozitës së pjesëmarrësit dhe burimit të financimit

LLOJI I PJESËMARRËSIT	Pjesëmarrësi / lloji i të ardhurave	Shuma e të ardhurave
OPOZITA		292.963.502
	Koalicioni i udhëhequr nga PLD	17.381.881
	RPP	5.947.681
	Mjete nga buxheti	11.434.200
	ALEANCA KOMBËTARE PËR INTEGRIM - AKI	119.357.514
	Donacion në shërbime ose sende nga personat juridik	90.000
	Donacion në shërbime ose sende nga personat fizik	90.000
	RPP	63.238.506
	Mjete nga buxheti	55.939.008
	PARTIA POLITIKE LEVICA	6.568.069
	Donacion në para nga persona fizik	1.140
	Donacion në shërbime ose sende nga personat fizik	92.250
	Mjete nga buxheti	6.474.679
	Koalicioni i udhëhequr nga LSDM	149.656.038
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	3.000
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat fizik	469.450
	Donacion në para nga persona fizik	511.000
	Donacion në shërbime ose sende nga personat juridik	3.000
	Donacion në shërbime ose sende nga personat fizik	23.000
	RPP	64.216.588
	Mjete nga buxheti	84.430.000
KANDIDATË TË PAVARUR TË MBËSHTETUR NGA NJË GRUP VOTUESISH		4.390.479
	Kandidatë të pavarur të mbështetur nga një grup votuesish	4.390.479
	Donacion në para nga personat juridik	2.397.500
	Donacion në para nga persona fizik	1.658.727
	Donacion në shërbime ose sende nga personat juridik	19.585
	Donacion në shërbime ose sende nga personat fizik	39.340
	RPP	275.327

Tabela 2: Shuma totale e të ardhurave sipas pozitës së pjesëmarrësit dhe burimit të financimit

LLOJI I PJESËMARRËSIT	Pjesëmarrësi / Iloji i të ardhurave	Shuma e të ardhurave
JOPARLAMENTARE		292.963.502
	VMRO – Partia Popullore	609.990
	RPP	9.990
	Mjete nga buxheti	600.000
	Partia Demokratike e Turqve	520.000
	Donacion në para nga personat juridik	20.000
	Donacion në para nga persona fizik	500.000
	Edinstvena Makedonija	2.545.100
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	2.500.000
	RPP	45.100
	MAAK Sopishte	156.750
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	140.000
	Donacion në para nga persona fizik	16.750
	PARTIA / PARTIA DEMOKRATIKE E ROMËVE	899.000
	Mjete nga buxheti	899.000
	Partia e Pensionistëve	142.807
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	120.807
	Donacion në para nga persona fizik	22.000
	Partia Politike “Iniciativa Qytetare” – GRIN	29.160
	RPP	29.160
	Partia Politike LËVIZJA PËR UNITET KOMBËTAR TË TURQVE	1.228.000
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	1.228.000
	Partia Politike DEMOKRATËT – Shkup	703.516
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	536.951
	Donacion në shërbime ose sende nga personat juridik	166.565
	Partia Politike Desnica	89.675
	Donacion në para nga persona fizik	89.675
	Partia Politike RODINA MAQEDONIA – Zgjedhjet Lokale 2025	354.347
	RPP	46.847
	Mjete nga buxheti	307.500

Tabela 2: Shuma totale e të ardhurave sipas pozitës së pjesëmarrësit dhe burimit të financimit

LLOJI I PJESËMARRËSIT	Pjesëmarrësi / lloji i të ardhurave	Shuma e të ardhurave
JOPARLAMENTARE		292.963.502
	Partia Politike TMRO	1.232.269
	RPP	52.269
	Mjete nga buxheti	1.180.000
PARTIA PUNËTORE		177.631
	RPP	177.631
	Partia Serbe	42.000
	Donacion në para nga persona fizik	22.000
	Mjete nga buxheti	20.000
Partia Jote Shkup – Fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale 2025		4.132.231
	Donacione në llogarinë kryesore nga personat juridik	3.000.000
	RPP	1.132.231

Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK nga raportet e përgjithshme financiare

4.1.2. Të ardhura për Reklamim Politik të Paguar (RPP)

RPP paraqet një mekanizëm të veçantë për financimin e përfaqësimit mediatic të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, ku mjetet sigurohen nga buxheti i shtetit, ndërsa shpërndarja e tyre, mënyra e përdorimit dhe kontrolli rregullohen me Kodin Zgjedhor (neni 76-d). Karakteristika thelbësore e këtij sistemi është se mjetet buxhetore për RPP nuk u paguhen pjesëmarrësve, por paguhen përmes llogarisë buxhetore të KSHZ, drejtpërdrejt ndaj mediave, mbi bazën e faturave të dorëzuara dhe dokumentacionit tjetër mbështetës. Në raportet financiare të pjesëmarrësve këto mjete zakonisht evidentohen si të ardhura dhe njëherësh si shpenzime për RPP, gjë që mundëson gjurmë publike dhe verifikueshmëri të shumave të përdorura për fushatën mediatike.

Shuma e përgjithshme e mjeteve për RPP është e kufizuar me një limit ligjor, i shprehur si shumë për çdo zgjedhës të regjistruar, pa përfshirë TVSH-në. Në kontekstin e zgjedhjeve lokale, në përputhje me nenin 76-d të Kodit Zgjedhor, ky rregull ka një veçori shtesë: nëse në disa komuna/Qytetin e Shkupit zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve, për ato njësi aktivizohet një kornizë shtesë financimi për RPP për raundin e dytë, përsëri mbi bazën e numrit të zgjedhësve të regjistruar në territorin ku mbahet raundi i dytë. Kjo do të thotë se, ndryshe nga zgjedhjet parlamentare ku procesi zgjedhor zhvillohet në mënyrë të njëtrajtshme në nivel kombëtar, te zgjedhjet lokale korniza totale për RPP mund të ndryshojë për shkak të zhvillimit të raundit të dytë dhe numrit të komunave ku ai mbahet.

Sa i përket kriterëve për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për RPP, ligji ka vendosur parimin e shpërndarjes në bazë të marrëveshjes me shkrim, me kufij maksimalë të përcaktuar qartë sipas kategorive të pjesëmarrësve. Në thelb, mjetet shpërndahen në atë mënyrë që pjesa dominuese të rezervohet për dy partitë/subjektet më të mëdha në pushtet dhe dy partitë më të mëdha opozitare (deri në 90% të mjeteve), ndërsa pjesa e mbetur është e destinuar për partitë parlamentare që nuk formojnë grup parlamentar, si dhe për partitë joparlamentare dhe kandidatët.

Këto kritere të përcaktuara për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për RPP nuk sigurojnë një shpërndarje të qartë dhe proporcionale të mjeteve buxhetore për reklamim politik të paguar, sepse nuk parashikojnë shpërndarje për partitë parlamentare që kanë formuar grup parlamentar në Kuvend, por që nuk bëjnë pjesë në dy partitë më të mëdha të pushtetit ose të opozitës. Një rregullim i tillë normativ krijon pozitë të pabarabartë ndërmjet subjekteve parlamentare dhe paraqet rrezik për cenimin e parimit të barazisë dhe të konkurrencës së ndershme zgjedhore.


Në lidhje me këtë mënyrë të përcaktuar të shpërndarjes së mjeteve buxhetore për RPP, KSHPK ka kryer kontroll antikorrupsion të dispozitave nga neni 75 deri te neni 76-d të Kodit Zgjedhor dhe përgatiti Raport për kontrollin antikorrupsion të dispozitave të Kodit Zgjedhor, Kapitulli VI *Fushata zgjedhore*, me nën-titull “Përfaqësimi mediatik”, nga neni 75 deri te neni 76-d, i cili është bashkëngjitur këtij raporti (shtojca nr. XX).

Vëllimi total dhe shpërndarja e RPP në Zgjedhjet Lokale 2025

Sipas të dhënave të paraqitura në raportet financiare që janë dorëzuar në KSHPK, shuma totale e të ardhurave të raportuara për RPP arrin në **283.852.126 denarë**.

Pjesëmarrësit që janë pjesë e **pushtetit** kanë raportuar **149 milionë denarë**, ndërsa pjesëmarrësit që i përkasin **opozitës** kanë raportuar **133,4 milionë denarë**. Pjesa tjetër është e përqendruar te **subjektet joparlamentare**, me gjithsej **1,5 milionë denarë**. Kjo strukturë konfirmon se RPP, si masë buxhetore, në praktikë është shfrytëzuar pothuajse tërësisht nga subjektet me kapacitetin më të madh politik dhe me dukshmëri kombëtare, ndërsa pjesëmarrja e subjekteve joparlamentare dhe iniciativave qytetare mbetet marginale.

Grafiku 4: Të ardhurat për RPP sipas pozitës së pjesëmarrësit



Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK-së nga raportet e përgjithshme financiare


Shpërndarja sipas pjesëmarrësit dhe përqendrimi i mjeteve

Sipas të dhënave të paraqitura në raportet financiare të dorëzuara në KSHPK, shpërndarja sipas pjesëmarrësve individualë tregon se katër subjekte dominojnë në shfrytëzimin e RPP, dhe ato janë: koalicionet e udhëhequra nga **VMRO-DPMNE (99.297.173 denarë)**, koalicionet e udhëhequra nga **LSDM (64.216.588 denarë)**, Koalicioni **AKI – Aleanca Kombëtare për Integrim (63.238.506 denarë)** dhe **Koalicioni VLEN (44.694.646 denarë)**. Vetëm këta katër pjesëmarrës raportojnë **271.446.913 denarë**, ndërsa të gjithë pjesëmarrësit e tjerë së bashku raportojnë **12.709.700 denarë**.

Mjetet e tjera janë shpërndarë ndërmjet disa subjekteve me shuma dukshëm më të vogla: **PLD (5.947.681 denarë)** dhe **Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni – Bratska (4.899.486 denarë)** janë dy “përdoruesit më të vegjël” të vetëm

me shumë mbi **1 milion denarë**. Te subjektet joparlamentare, shumën më të lartë e ka **Partia Jote Shkup (1.132.231 denarë)**, ndërsa partitë e tjera joparlamentare kanë shuma simbolike (nga disa mijëra deri në disa qindra mijëra denarë), gjë që tregon se pjesëmarrja e tyre në hapësirën mediatike përmes RPP në të vërtetë është e kufizuar.

Grafiku 5: Të ardhurat për RPP sipas pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore



Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK nga raportet financiare të përgjithshme

Këto raporte janë thelbësore për interpretimin e sistemit. Edhe pse RPP formalisht është një masë e destinuar për të siguruar përfaqësim mediatik dhe për të ulur presionin e financimit privat për fushata reklamuese, shpërndarja faktike tregon se efekti kryesor është i përqendruar te disa nga subjektet më të mëdha politike. Në praktikë, RPP e forcon kapacitetin mediatik pikërisht aty ku tashmë ekziston një infrastrukturë e zhvilluar organizative dhe një njohje e lartë politike.

Veçoritë e zgjedhjeve lokale dhe implikimet për analizën

Në zgjedhjet lokale, një sfidë shtesë analitike ka të bëjë me faktin se pjesëmarrësit, veçanërisht koalicionet dhe partitë e mëdha, shpesh hapin dhe përdorin më shumë llogari transaksionale që korrespondojnë me formatet e koalicioneve dhe me organizimin e fushatës sipas komunave. Për këtë arsye, numri i llogarive dhe fragmentimi i transaksioneve mund të ndryshojë ndjeshëm nga një pjesëmarrës te tjetri, gjë që kërkon agregim të kujdesshëm të të dhënave për të krijuar një pasqyrë reale të vëllimit të përgjithshëm të RPP për bartësin e koalicionit ose për subjektin politik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur krahasohen bartësit e koalicioneve më të mëdha, sepse shumat e tyre totale për RPP mund të jenë rezultat i mbledhjes së disa llogarive komunale ose koalicionesh, dhe jo i një llogarie të vetme në nivel qendror.

Në nivel sistemi, RPP mbetet instrumenti buxhetor më i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në praninë mediatike të pjesëmarrësve në fushatë. Shpërndarja e mjeteve e përcaktuar me nenin 76-d të Kodit Zgjedhor dhe të dhënat e përpunuara nga Zgjedhjet Lokale 2025 tregojnë këtë situatë:

- (1) një ndarje pothuajse të barabartë ndërmjet partive në pushtet dhe partive në opozitë,
- (2) një përqendrim jashtëzakonisht të lartë të mjeteve te katër subjekte politike, dhe
- (3) një shumë të ulët mjeteve të dedikuara për subjektet joparlamentare dhe grupet e votuesve.

4.2. Shpenzimet

Shpenzimet në fushatën zgjedhore i përfshijnë të gjitha mjetet reklamuese që përdoren gjatë fushatës me qëllim promovimin e programit dhe ideve të pjesëmarrësve në zgjedhje. Në përputhje me dispozitat e nenit 84 të Kodit Zgjedhor, një pjesëmarrës në zgjedhje mund të shpenzojë maksimumi deri në 110 denarë për çdo zgjedhës të regjistruar në njësinë zgjedhore ose në komunën për të cilën ka paraqitur listë kandidatësh për të gjitha raundet e zgjedhjeve. Në raportet financiare të dorëzuara, pjesëmarrësit kanë raportuar shpenzime totale në shumën prej 311.397.462 denarësh.

Në përpunimin e të dhënave nga raportet përfundimtare dhe për nevojat e analizës së shpenzimeve, paraqitjet e koalicioneve evidentohen dhe analizohen sipas bartësit të koalicionit, me qëllim që të sigurohet një qasje e unifikuar dhe juridikisht e saktë në interpretimin e të dhënave. Edhe pse në dokumentacionin financiar dhe në evidencën bankare koalicionet paraqiten përmes disa llogarive të veçanta, në tekst ato trajtohen si subjekt i përmbledhur sipas bartësit të koalicionit. Në këtë drejtim, koalicioni “Tvoja Makedonija” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE paraqitet përmes gjithsej njëmbëdhjetë (11) llogarive të evidentuara, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga LSDM përmes katër (4), ndërsa koalicionet e tjera kanë marrë pjesë me një llogari zgjedhore. Kjo qasje mundëson krahasueshmëri analitike më të qëndrueshme të të ardhurave dhe shpenzimeve, pa e humbur nga vështrimi faktin se bëhet fjalë për llogari të shumta lokale të të njëjtit bartës koalicioni.

Së këtejmi, për shkak të fragmentimit të theksuar të të dhënave të listat e pavarura (grupet e votuesve), numrit të madh të pjesëmarrësve dhe shumave kryesisht të vogla individuale të donacioneve dhe shpenzimeve, në pjesën narrative ato do të paraqiten si një shumë e agreguar, përveç rasteve kur një pjesëmarrës i veçantë dallon me një shumë më të lartë ose me një strukturë specifike shpenzimesh që është relevante për analizën.

Të dhënat e marra nga përpunimi i raporteve financiare të përgjithshme tregojnë përqendrim të lartë të shpenzimeve te një numër i kufizuar pjesëmarrësish. Tre pjesëmarrësit më të mëdhenj përbëjnë 81,7% të shpenzimeve në total të raportuara. Në tabelën në vijim paraqitet struktura e shpenzimeve të realizuara në llogaritë e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

Tabela 3: Shpenzimet totale sipas llojit të shpenzimit

Lloji i shpenzimit	Shuma e paguar	Pjesëma rrja
Shpenzime për reklamë dhe propagandë	237.797.200	76,4 %
Shpenzime për mbajtjen e tubimeve parazgjedhore	25.030.083	8,0 %
Shërbime intelektuale	18.906.499	6,1 %
Shërbime transporti	13.384.339	4,3 %
Shpenzime për përfaqësim	5.372.576	1,7 %
Marrja me qira e hapësirës gjatë fushatës zgjedhore	4.359.759	1,4 %
Shpenzime të tjera	3.353.926	1,1 %
Shërbime për hulumtime statistikore	3.193.080	1,0 %
GJITHSEJ	301.346.776	100 %

Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK nga raportet e përgjithshme financiare

Struktura e shpenzimeve tregon qartë se pjesa më e madhe e mjeteve është drejtuar për reklamë dhe propagandë, me gjithsej 237.797.200 denarë, përkatësisht 76,4% të të gjitha shpenzimeve të raportuara. Kjo kategori përfshin shpenzime për: promovim, prodhim dhe shpërndarje të materialeve promovuese, shërbime kreative dhe marketingu, si dhe shërbime të tjera promovuese që mbështesin dukshmërinë e kandidatëve dhe listave të këshilltarëve në publik.

Kategoria e dytë më e rëndësishme janë shpenzimet për mbajtjen e tubimeve parazgjedhore, në shumën 25.030.083 denarë (8,0%). Këto shpenzime zakonisht kanë të bëjnë me organizimin e ngjarjeve publike dhe aktiviteteve në terren, logjistikën për tubime, mbështetjen teknike, angazhimin e shërbimeve për sistemin e zërimit, sigurim dhe nevoja të ngjashme organizative.

Kategoria e tretë sipas vëllimit janë shërbimet intelektuale, me 18.906.499 denarë (6,1%). Në këtë grup zakonisht përfshihen shërbime intelektuale, angazhime konsulente, shërbime komunikimi dhe PR, hulumtime të opinionit publik dhe mbështetje analitike për fushatën.

Transporti dhe logjistika marrin pjesë me 13.384.339 denarë (4,3%), që më së shpeshti kanë të bëjnë me shpenzime për shërbime transporti, logjistikë për aktivitete në terren dhe mbështetje operative. Rezentacioni dhe shërbimet hotelierike janë raportuar me 5.372.576 denarë (1,7%), gjë që tregon një shkallë të caktuar përdorimi të shërbimeve hotelierike dhe protokollare, kryesisht në kontekst të ngjarjeve, takimeve dhe organizimit në terren.

Marrja me qira e hapësirës gjatë fushatës arrin në 4.359.759 denarë (1,4%) dhe lidhet me funksionimin e shtabeve, zyrave lokale dhe pikave të tjera logjistike që janë tipike për zgjedhjet lokale, për shkak të nevojës për praninë e pjesëmarrësve në disa komuna njëkohësisht. Kategoritë e tjera, si shtypi dhe botimet (762.461 denarë), materialet dhe shpenzimet e vogla (607.485 denarë) dhe shpenzimet financiare dhe detyrimet (224.099 denarë), kanë pjesëmarrje të vogël dhe përfaqësojnë shpenzime administrative dhe operative.

Shpërndarja e shpenzimeve sipas llojit të pjesëmarrësit tregon një dominim të theksuar të koalicioneve. Koalicionet kanë raportuar 280.323.653 denarë, përkatësisht 90% të shpenzimeve totale. Partitë politike kanë raportuar 25.734.671 denarë (8,3%), ndërsa grupet e votuesve kanë raportuar 5.339.138 denarë (1,7%).

Tabela 4: Shpenzimet totale sipas llojit të pjesëmarrësit

Lloji i pjesëmarrësit	Shuma e paguar	Pjesëmarrja
Koalicion	280.323.653	90,0 %
Parti	25.734.671	8,3 %
Kandidatë të pavarur të mbështetur nga një grup votuesish	5.339.138	1,7 %
GJITHSEJ	311.397.462	100.00 %

Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK nga raportet e përgjithshme financiare

Sa i përket pozicionit politik, pjesëmarrësit që i përkasin opozitës kanë raportuar afërsisht 160 milionë denarë (53%), ndërsa pjesëmarrësit që i përkasin pushtetit kanë raportuar mbi 128 milionë denarë (42,5%). Subjektet joparlamentare kanë raportuar 21 milionë denarë (7,1%), ndërsa grupet e votuesve 4,5 milionë denarë (1,5%).

Nga aspekti i pjesëmarrësve individualë, shpenzimet më të larta janë evidentuar te Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, me gjithsej 121.108.544 denarë (40,2% të shpenzimeve totale). Të dytat për nga vëllimi i shpenzimeve janë evidencat në lidhje me Koalicionin e udhëhequr nga LSDM, me gjithsej 85.172.170 denarë (28,3% të shpenzimeve totale). Koalicioni Aleanca Kombëtare për Integrim (AKI) ka raportuar shpenzime në shumën totale prej 55.908.775 denarë (18,5% të shpenzimeve totale).

Tabela 5: Shpenzimet totale sipas pjesëmarrësit dhe llojit të shpenzimit

Pjesëmarrësi	Shpenzime për reklamë dhe propagandë	Shpenzime për tubime parazgjedhore	Shërbime intelektuale	Shërbime transporti	Shpenzime për reprezentacion	Qiradhënie të hapësirës gjatë fushatës zgjedhore	Shërbime për hulumtime statistikore	Shpenzime të tjera	GJITHSEJ
VMRO – Partia Popullore	268.364		35.625		58.187			20.379	6.717.964
Lëvizja ZNAM PËR MAQEDONINË TONË	10.046.270							66.053	428.229
Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni - Bratska					69.206			786.314	5.339.138
Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni	481.885							4.416	10.050.686
ALEANCA DEMOKRATIKE								41.229	110.435
Edinstvena Maekdonija	1.760.482		32.222					2.289	484.174
Koalicioni VLEN	5.667.648			18.237		1.011.700		119.124	119.124
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	95.666.343	8.100.366	10.454.184	6.375.000		31.230		396.307	2.189.011
Koalicioni i udhëhequr nga PLD	7.297.837		4.100.000		7.922			10.441	11.416.200
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM	70.523.022	8.014.587	1.463.736	1.048.213	197.600	3.184.719		9.149	154.241
MAAK Sopishte	136.596					8.496			17.582
KONCEPTI MAQEDONAS					17.582		3.193.080	355.644	55.908.775
ALEANCA KOMBËTARE PËR INTEGRIM - AKI	34.461.991	8.915.130		5.563.880	3.419.050			12.619	899.000
PARTIA DEMOKRATIKE E ROMËVE	877.741				8.640			32.044	142.807
Partia e Pensionistëve	52.763			56.000		2.000		21.617	1.228.000
PARTIA POLITIKE LËVIZJA PËR UNITET KOMBËTAR TË TURQVE	1.010.698			195.685				32.073	703.516
Partia Politike DEMOKRATËT Shkup	451.363		185.699	25.230	9.151			130	89.675
Partia Politike Desnica	89.545							3.764	6.475.819
PARTIA POLITIKE LEVICA	4.903.363		1.418.796	102.094		47.802		31.015	112.789

Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK nga raportet e përgjithshme financiare

Tabela 5: Shpenzimet totale sipas pjesëmarrësit dhe llojit të shpenzimit

Pjesëmarrësi	Shpenzime për reklamë dhe propagandë	Shpenzime për tubime parazgjedhore	Shërbime intelektuale	Shërbime transporti	Shpenzime për reprezentacion	Qiradhënie të hapësirës gjatë fushatës zgjedhore	Shërbime për hulumtime statistikore	Shpenzime të tjera	GJITHSEJ
Partia Politike RODINA Maqedonia – Zgjedhjet lokale 2025	81.774							102.736	1.230.553
Partia Politike TMRO	712.201		362.224		40.205	13.187		740.293	85.172.170
Partia Serbe në Maqedoni – Zgjedhjet lokale 2025	21.070							14.160	35.230
Partia Jote Shkup – fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale 2025	309.256		822.975		60.860			70.709	1.263.800
Kandidatë të pavarur të mbështetur nga një grup votuesish	2.976.988		31.038		1.484.173	60.625		481.421	121.108.544
GJITHSEJ	237.797.200	25.030.083	18.906.499	13.384.339	5.372.576	4.359.759	3.193.080	3.353.926	311.397.462

Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK nga raportet e përgjithshme financiare

Përveç këtyre tre pjesëmarrësve, të cilët së bashku përbëjnë rreth 87,0 % të shpenzimeve totale, pasojnë pjesëmarrës me një shumë dukshëm më të vogël shpenzimesh. Koalicioni i udhëhequr nga PLD ka evidentuar shpenzime në shumë totale 11.416.200 denarë (3,8 %), me shumën më të mëdha të shpenzuara për reklamim (7.297.837 denarë) dhe shërbime intelektuale (4.100.000 denarë). Partia politike „Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë Tonë“, në raportin përfundimtar financiar ka evidentuar shpenzime në shumën prej 10.050.686 denarë, kryesisht të destinuara për reklamim, promovim dhe shtypje të materialeve promovuese. Koalicioni VLEN ka evidentuar shpenzime në shumën totale 6.717.964 denarë (2,2 %), kryesisht në reklamim (5.667.648 denarë) dhe marrje me qira të hapësirës (1.011.700 denarë). Partia Politike Levica ka evidentuar shpenzime në shumën totale 6.475.819 denarë (2,1 %), ku reklamimi (4.903.363 denarë) dhe shërbimet intelektuale (1.418.796 denarë) përbëjnë zërat kryesorë. Grupet e votuesve, me 5.339.138 denarë (1,8 %), kanë evidentuar një strukturë të ndryshme shpenzimesh, me një pjesëmarrje më të madhe të “shpenzimeve për përfaqësim” (1.484.173 denarë) krahas reklamimit (2.976.988 denarë).

4.2.1. Shpenzimet për reklamim politik të paguar

Reklamimi Politik i Paguar (RPP) paraqet një segment specifik të shpenzimeve në fushatën zgjedhore, sepse ka të bëjë me mjete që sigurohen nga buxheti dhe janë të destinuara ekskluzivisht për përfaqësimin mediatik të pjesëmarrësve përmes radiodifuzerëve, mediave të shtypura dhe mediave elektronike (portaleve të internetit).

Në këtë pjesë është bërë një analizë e shpenzimeve për RPP për Zgjedhjet Lokale 2025, bazuar në të dhënat nga raportet përfundimtare të dorëzuara në KSHPK nga pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, të paraqitura sipas pjesëmarrësit ndërkaq në mënyrë plotësuese edhe sipas statusit politik (pushtet / opozitë), si dhe sipas llojit të pjesëmarrjes (parti / koalicion / kandidatë të pavarur të mbështetur nga një grup votuesish / subjekte joparlamentare). Gjatë interpretimit është marrë parasysh edhe praktika e zgjedhjeve lokale, ku fushatat zhvillohen përmes më shumë llogarive transaksionale dhe më shumë kontratave sipas komunave.

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, ekzistojnë dy kufizime kryesore që janë relevante për këtë analizë: (1) shuma maksimale që një pjesëmarrës mund t’ia paguajë një medias elektronike (portal interneti) ose medias të shtypur nuk duhet të tejkalojë 15.000 euro në kundërvlerë në denarë pa TVSH; dhe (2) shuma totale për përfaqësim mediatik e paguar në të gjitha mediat elektronike dhe të shtypura nuk mund të tejkalojë 25% të mjeteve financiare të akorduara për këtë qëllim.

Sipas të dhënave të dorëzuara nga raportet financiare, shpenzimet totale të realizuara për RPP të pjesëmarrësit në Zgjedhjet Lokale 2025 arrijnë në 284.156.613 denarë. Shpërndarja e mjeteve është pothuajse e barabartë ndërmjet: pjesëmarrësve që i përkasin pushtetit, të cilët kanë realizuar 148.985.283 denarë, dhe pjesëmarrësve nga opozita, me 133.402.775 denarë. Pjesa tjetër ka të bëjë me subjektet joparlamentare, me 1.493.228 denarë. Të gjitha këto të dhëna vënë në dukje se fushata mediatike mbështetet pothuajse plotësisht në mjete buxhetore.

Struktura e shpenzimeve sipas llojit të medias për Zgjedhjet Lokale 2025 tregon një dominim të qartë të televizioneve. Për reklamim politik të paguar në televizione janë paguar 170.591.902 denarë (64,3% e RPP totale), për portalet e internetit 67.553.959 denarë (25,5%), për radiodifuzerët 22.230.744 denarë (8,4%), ndërsa për mediat e shtypura 4.988.741 denarë (1,9%).

Në nivel të pjesëmarrësve, katër subjekte politike kanë shfrytëzuar 95,5% të shumës totale të destinuar për RPP: Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE me 99.297.176 denarë, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM me 64.216.588 denarë, Koalicioni AKI me 63.238.506 denarë, dhe Koalicioni VLEN me 44.694.646 denarë.

KSHPK siguroi të dhëna për shpenzimet e paguara për RPP nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, ku u konstatua se shuma totale e mjeteve të paguara për RPP për të gjithë 166 pjesëmarrësit në procesin zgjedhor arrin në 294.075.396 denarë.

Grafiku 6: Të ardhurat nga RPP sipas pozicionit të pjesëmarrësit




Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK nga raportet e përgjithshme financiare.

5. VENDIME NË KOMPETENCË TË KSHPK

Gjatë periudhës së procesit zgjedhor, KSHPK ka formuar gjithsej 43 (dyzet e tre) lëndë, të cilat janë rezultat i paraqitjeve për dyshime për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, si dhe lëndë të hapura me iniciativë të vetë Komisionit.

Grafiku 7: Numri i lëndëve të pranura sipas bazës së paraqitjes



Burimi: Të dhëna administrative të KSHPK

5.1. Lëndë sipas denoncimeve/raportimeve

Në KSHPK janë dorëzuar gjithsej 42 (dyzet e dy) denoncime, me dyshime për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit gjatë periudhës së procesit zgjedhor.

KSHPK-ja ka vepruar në gjithsej 38 (tridhjetë e tetë) lëndë, nga të cilat në 33 (tridhjetë e tre) lëndë është marrë vendim për ndërprerjen e procedurës, ndërsa në 3 (tri) lëndë është marrë vendim për hedhjen poshtë të denoncimit. Për një lëndë kanë konkluduar të bashkohet me një lëndë tjetër me pretendime të njëjta ose të ngjashme, ndërsa për një lëndë tjetër është konkluduar për rishpërndarje dhe veprim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Denoncuesve.

Pas analizës së kryer mbi përmbajtjen e denoncimeve të adresuara, është konstatuar si vijon:

- numri më i madh i tyre, përkatësisht 19 (nëntëmbëdhjetë) denoncime, i referohen pretendimeve për dyshime për parregullsi në procedurat e punësimit ose të ndërprerjes së marrëdhënies së punës gjatë periudhës zgjedhore, të përfshira në dispozitën e nenit 8-a paragrafi 1 alineja 3 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 34 paragrafi 1 alineja 3 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Me qëllim verifikimin e pretendimeve dhe përcaktimin e gjendjes faktike, KSHPK-ja dërgoi kërkesa për veprim kompetent pranë shërbimeve inspektuese, si dhe pranë subjekteve të përfshira me denoncimet/raportimet. Në bazë të të dhënave dhe informacioneve relevante të siguruar dhe gjendjes faktike të konstatuar, KSHPK-ja ka marrë vendime në kompetencë të saj për 16 (gjashtëmbëdhjetë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) denoncimet e dorëzuara me dyshime për parregullsi në punësime ose

ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë periudhës zgjedhore, ndërsa një lëndë me konkluzion është bashkuar me një lëndë tjetër.

- pretendimet e 5 (pesë) denoncimeve kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave të nenit 8-a paragrafi 2 alineja 1 të Kodit Zgjedhor, dispozitë që i referohet ndalimit të mbajtjes së ngjarjeve publike për fillimin e ndërtimit ose vënien në përdorim të objekteve me mjete buxhetore, të fondeve publike, ndërmarrjeve publike ose personave të tjerë juridikë që disponojnë kapital shtetëror. Në lidhje me këto denoncime, KSHPK konstatoi se një pjesë e tyre nuk janë mbajtur gjatë periudhës zgjedhore, përkatësisht ngjarjet janë mbajtur para fillimit të zgjedhjeve, ndërsa për një pjesë tjetër është konstatuar se nuk është kryer shkelje e dispozitave të nenit 8-a paragrafi 2 alineja 1 të Kodit Zgjedhor. KSHPK-ja deri më tani ka marrë vendim për 4 (katër) nga 5 (pesë) lëndët e formuara, ndërsa për një lëndë procedura është në vijim e sipër.
- për 3 (tri) lëndë, KSHPK-ja konstatoi se bëhet fjalë për denoncime lidhur me dyshime për mitëdhënie votuesve, gjë që përcaktohet në nenin 8-b paragrafin 6 të Kodit Zgjedhor, me ç'rast ka ndërmarrë aktivitete në përputhje me nenin 37 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe ka dërguar Njoftim për rastin e raportuar te komisioni i përkohshëm kompetent në Prokurorinë Publike, për ndjekjen e parregullsive të mundshme zgjedhore, për veprim në kompetencë të saj.
- në 2 (dy) denoncime janë përfshirë pretendime për dyshimin për shkelje të dispozitës së nenit 8-a paragrafi 1 alineja 1 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 34 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e një rruge dhe kryerjen e punimeve ndërtimore në dy komuna të ndryshme, për të cilat KSHPK-ja ka marrë vendim në seancë publike.
- në KSHPK janë dorëzuar 2 (dy) denoncime me dyshime për shkelje të nenit 8-b paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor, për keqpërdorim të automjeteve zyrtare për aktivitete partiake gjatë fushatës. Për njërin nga këto dy lëndë është marrë vendim, ndërsa tjetra procedohet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Denoncuesve.
- është paraqitur një denoncim për shkelje të nenit 8-a paragrafi 1 alineja 2 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 34 paragrafi 1 alineja 2 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, me pretendime se me vendimmarrjen janë krijuar kushte për rritjen e pagave dhe kompensimeve të pagave për një pjesë të administratës komunale, për të cilën është marrë vendim në kompetencë të KSHPK-së.
- në 10 (dhjetë) paraqitjet e tjera përmbahen pretendime me dyshime për parregullsi që nuk janë të përfshira në Kodin Zgjedhor ose për të cilat KSHPK ka konstatuar se nuk ka kompetencë për të vepruar, dhe për to janë marrë vendime nga kompetenca e KSHPK.

Gjatë veprimit të KSHPK-së sipas denoncime të paraqitura, në një lëndë është konstatuar shkelje e dispozitave të nenit 36 paragrafi (1) të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe të nenit 8-b të Kodit Zgjedhor, për shkak të dyshimit për keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga drejtori i një ndërmarrjeje publike, i cili kishte mundur përdorimin e autobusëve në pronësi të ndërmarrjes për reklamim politik, në kundërshtim me dispozitat e specifikuar ligjore. Për shkak të kësaj, KSHPK-ja ka paraqitur iniciativë për ndjekje penale në Prokurorinë Publike të RMV-së kundër drejtorit të ndërmarrjes publike.

5.2. Lëndë sipas iniciativës vetjake

KSHPK-ja formoi 1 (një) lëndë me iniciativë vetjake, pas informimit nga mediat, për të cilën procedura është në vijim e sipër.

6. RAPORTIMI FINANCIAR

Raportimi financiar në procesin zgjedhor është i përcaktuar në nenet 84-b dhe 85 të Kodit Zgjedhor dhe paraqet një mekanizëm thelbësor për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe ligjshmërisë në grumbullimin dhe përdorimin e mjeteve për fushatën zgjedhore. Në sistemin e financimit të fushatave zgjedhore, raportet financiare nuk janë vetëm një detyrim formal, por edhe një instrument kyç për mbikëqyrje publike dhe kontroll institucional, përmes të cilit monitorohen burimet e mjeteve, dinamika e të ardhurave dhe shpenzimeve të mjeteve, respektimi i kufijve të lejuar, si dhe afatet dhe plotësia e raportimit.

Për zgjedhjet lokale, raportimi financiar merr një kompleksitet shtesë për shkak të strukturës së procesit zgjedhor. Së pari, fushata zgjedhore realizohet në dy raunde, gjë që nënkupton më shumë momente kritike për raportim dhe afate shtesë për dorëzimin e të dhënave. Së dyti, në zgjedhjet lokale shfaqet një organizim i ndryshëm i pjesëmarrësve, veçanërisht te koalicionet dhe te partitë politike që marrin pjesë me kandidatura dhe lista të ndryshme në nivel komunash, gjë që në praktikë rezulton me hapjen e më shumë llogarive transaksionale për fushatën zgjedhore. Së treti, e rëndësishme është edhe prania e kandidatëve të pavarur të mbështetur nga grupe votuesish, si pjesëmarrës që për nga natyra kanë kapacitete më të kufizuara administrative dhe financiare, gjë që reflektohet në cilësinë dhe kohën e raportimit financiar. Në përputhje me kornizën ligjore për financimin e fushatave zgjedhore, pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore janë të detyruar të sigurojnë një llogari të veçantë transaksionale për fushatën zgjedhore, përmes së cilës realizohen të gjitha hyrjet dhe pagesat që lidhen me aktivitetet zgjedhore. Përveç kësaj, ata kanë detyrim që brenda afateve të përcaktuara të dorëzojnë raporte financiare me të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës. Këto raporte dorëzohen te institucionet kompetente dhe publikohen në mënyrën e përcaktuar me Kodin Zgjedhor, duke siguruar kështu transparencë dhe verifikueshmëri të të dhënave.

6.1. Afatet dhe pikat kritike në raportimin për zgjedhjet lokale

Në procesin zgjedhor të zgjedhjeve lokale, raportimi përmes raporteve realizohet në disa faza që korrespondojnë me dinamikën e fushatës dhe modelin zgjedhor me dy raunde. Në tabelën (p.sh. 1) është evidentuar përmbushja e detyrimeve të pjesëmarrësve në fushatë sipas këtyre pikave: raport me formular për donacionet e pranuar në llogarinë transaksionale për fushatën zgjedhore në ditën e 11-të të fushatës, raport me formular për donacionet e pranuar në llogarinë transaksionale për fushatën zgjedhore një ditë para mbajtjes së raundit të dytë, raport me formular për donacionet e pranuar në llogarinë transaksionale për periudhën prej ditës së parë pas përfundimit të fushatës deri në mbylljen e llogarisë transaksionale, si dhe raporti i përgjithshëm financiar me specifikim të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore dhe evidencë për statusin e mbylljes së llogarisë. Në këtë model është thelbësore dallimi ndërmjet pjesëmarrësve që e përfundojnë fushatën në raundin e parë dhe atyre që vazhdojnë në raundin e dytë, sepse tek këta të fundit paraqitet një detyrim shtesë për raportim para mbajtjes së raundit të dytë të votimit, si dhe nevoja për përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave financiare.

6.2. Roli mbikëqyrës dhe aktivitetet e KSHPK

Në kuadër të kompetencave të tij, KSHPK-ja monitoron përmbushjen e detyrimeve për raportimin financiar, përfshirë dorëzimin në kohë të raporteve, plotësinë e tyre dhe përputhshmërinë me dispozitat ligjore për financimin e fushatës.

Komisioni e ushtron këtë funksion përmes analizës së raporteve të dorëzuara, krahasimit të të dhënave me ekstraktet bankare, identifikimit të mospërputhjeve dhe konstatimit të rasteve të mosdorëzimit ose vonesës së raporteve. Kur konstatohen mangësi, KSHPK-ja ndërmerr veprime përkatëse në përputhje me autorizimet ligjore, përfshirë njoftimin e organeve kompetente dhe iniciimin e procedurave kur plotësohen kushtet.

Për shkak të vakumit juridik të legjislacionit, KSHPK-ja përballet me kufizime në veprimin e saj, siç është rasti i mungesës së sanksioneve kundërvajtëse për mosdorëzimin e raporteve financiare nga pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, në përputhje me nenin 84-b dhe nenin 85 të Kodit Zgjedhor, gjë që vë në dukje nevojën për ndryshime ligjore për të mundësuar menaxhim më efikas të procedurave dhe sanksioneve.

6.3. Gjetjet nga tabela për raportet e dorëzuara dhe llogaritë e mbyllura

Sipas evidencës së dorëzuar, në procesin zgjedhor janë identifikuar gjithsej 166 llogari transaksionale të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore. Ky numër pasqyron specifikën e zgjedhjeve lokale: një parti politike ose koalicion mund të ketë më shumë llogari që korrespondojnë me konfigurime të ndryshme koalicionesh ose me performance të ndryshme lokale, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e llogarive kanë të bëjnë edhe me grupe votuesish.

Një segment veçanërisht i rëndësishëm është statusi i mbylljes së llogarive transaksionale. Mbyllja e llogarisë ka dy funksione: formalisht e përmbyll ciklin financiar të fushatës dhe mundëson verifikimin përfundimtar nëse janë përmbushur të gjitha detyrimet dhe nëse kanë mbetur mjete të pashfrytëzuara.

Në kontekstin e procesit zgjedhor me dy raunde, një tregues shtesë për disiplinën e pjesëmarrësve është dorëzimi i raportit “një ditë para raundit të dytë”, aty ku zhvillohet raundi i dytë. Mbikëqyrja e kësaj kolone mundëson të përcaktohet nëse pjesëmarrësit që e kanë vazhduar fushatën në raundin e dytë kanë ruajtur llogaridhënien e vazhdueshme dhe informimin në kohë. Të dhënat tregojnë se një pjesë e pjesëmarrësve që kanë llogari aktive në periudhën ndërmjet dy raundeve nuk kanë dorëzuar raport brenda afatit ligjor, gjë që përbën tregues rreziku për ulje të transparencës, pikërisht në fazën kur fushata vazhdon dhe kur, zakonisht, aktivitetet intensifikohen.

7. DOBËSITË E KODIT ZGJEDHOR

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit konstatoi se ekzistojnë dobësi të konsiderueshme në përcaktimin ligjor që i rregullon proceset zgjedhore, gjë që krijon nevojë për përmirësimin, ndryshimin, plotësimin dhe harmonizimin e tij. Përveç disa ndryshimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, akoma ekzistojnë zbrazëtira dhe çështje të parregulluara që ndikojnë seriozisht në punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe në monitorimin efektiv të zbatimit të proceseve zgjedhore.

Dobësitë sistematike në procesin zgjedhor në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë pasojë e aspekteve të ndryshme të kornizës ligjore dhe institucionale. Këto dobësi janë reflektim i mangësive në rregullimin ligjor, si dhe i problemeve në zbatimin dhe menaxhimin e proceseve zgjedhore. Fushat kryesore të shqetësimit janë mungesa e debatit publik, problemet me transparencën dhe zbatimin e akteve të reja normative, burimet e kufizuara dhe trajnimi i administratës zgjedhore, si dhe mungesa e mbështetjes së institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet. Këto probleme çojnë në pasiguri dhe paparashikueshmëri në procesin zgjedhor, gjë që mund të ndikojë në stabilitetin dhe efikasitetin e tij.

Administrata zgjedhore, përfshirë edhe Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, ka burime të kufizuara njerëzore dhe financiare, gjë që mund të ndikojë në përgatitjen në kohë dhe komunikimin me organet e tjera zgjedhore dhe me publikun. Këto dobësi e theksojnë nevojën për përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale të procesit zgjedhor, me qëllim që të sigurohet stabilitet më i madh, transparencë dhe efikasitet i zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Dobësitë kryesore të Kodit Zgjedhor

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit konstatoi nevojën për përmirësimin e rregullimit ligjor që i rregullon çështjet nga fusha e proceseve zgjedhore, në drejtim të ndryshimit, plotësimit dhe harmonizimit të tij. Në vijim specifikohen dobësitë e konstatuara:

- **Saktësia e akteve normative për financim:** Është e nevojshme të rishikohen dhe të saktësohen më tej dispozitat e nenit 83 paragrafi 2, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me financimin e fushatës zgjedhore nga llogaria e rregullt e partisë politike dhe nga donacionet. Kjo i referohet vendosjes së kufijve individualë dhe të përgjithshëm për mjetet e financuara ose të dhuruara nga persona fizikë dhe juridikë, me qëllim që të parandalohet ndikimi i tepruar i interesave private, por edhe të kufizohet financimi i tepruar i aktiviteteve zgjedhore me mjete shtetërore që kanë një qëllim krejtësisht tjetër.
- **Kriteret e parregulluara sa duhet për financimin buxhetor:** Në kushtet e financimit të fushatave zgjedhore me mjete buxhetore, neni 76-d duhet të rregullohet më tej duke përcaktuar kritere të matshme për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për reklamim politik të paguar, si dhe të shmangen mospërputhjet që kanë bërë që disa pjesëmarrës të privohen nga mundësia për të marrë mjete për reklamim politik të paguar nga buxheti.
- **Kriteret e përcaktuara për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për RPP** nuk sigurojnë një shpërndarje të qartë dhe proporcionale të mjeteve buxhetore për reklamim politik të paguar, sepse nuk parashikojnë shpërndarjen e mjeteve për partitë parlamentare që kanë formuar grup parlamentar në Kuvend, por që nuk janë pjesë e dy partive më të mëdha në pushtet ose në opozitë.

- **Paqartësi në lidhjen e donatorëve:** Ekziston nevoja të rregullohet mënyra se si donatorët do të dëshmojnë se nuk janë “persona të lidhur” me radiodifuzerët, mediat e shtypura dhe mediat elektronike gjatë financimit ose dhurimit për partitë politike. Kjo është thelbësore për shmangien e konfliktit të interesit dhe për sigurimin e transparencës gjatë financimit.
- **Dispozita të pasakta për mjetet e tepërta dhe detyrimet e papaguara:** Dispozitat e nenit 85 duhet të rishikohen për të përcaktuar një mënyrë të qartë veprimi kur zbulohen mjete të tepërta në llogarinë e fushatës zgjedhore, ose në rast detyrimesh të papaguara pas mbylljes së llogarive zgjedhore.
- **Mbështetja e kandidatëve të pavarur nga koalicionet dhe partitë:** Është e nevojshme të rregullohen kushtet në të cilat një koalicion ose parti politike mund të mbështesë një kandidat të pavarur dhe të përdorë mjete për reklamim politik të paguar në favor të këtij kandidati, si dhe të përcaktohen më qartë kushtet dhe mënyra e mbështetjes të tillë.
- **Monitorimi i përfaqësimit mediatic:** Është i domosdoshëm rishikimi i Kodit Zgjedhor për të përcaktuar organin kompetent për monitorimin dhe raportimin e përfaqësimit mediatic në portalet e internetit gjatë zgjedhjeve.
- **Zbatimi i sistemeve interoperabile:** Neni 76-d paragrafi 11 duhet të plotësohet me vendosjen e një sistemi interoperabil për shkëmbimin dhe kontrollin e të dhënave mbi aktivitetin e banerëve, në të cilin do të përfshihen të gjitha palët e interesuara.
- **Rregullimi i pjesëmarrjes në fushatën zgjedhore përmes rrjeteve sociale:** Ekziston nevoja për rregullimin e mënyrës së organizimit, pagesës, monitorimit dhe raportimit të organet kompetente për përfaqësimin në internet që realizohet nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore përmes rrjeteve sociale.
- **Media elektronike – kushtet dhe kriteret:** Ka nevojë për rishikimin e mëtejshëm të kushteve dhe kriterëve që duhet ti plotësojnë mediat elektronike për të pasur mundësi të aplikojnë për reklamim politik në KSHZ.
- **Shpërndarja e mjeteve buxhetore për reklamim politik të paguar:** Përcaktimi i kriterëve të qarta dhe të sakta për shpërndarjen e mjeteve buxhetore të destinuara për reklamim politik të paguar në mediat elektronike (portalet e internetit).
- **Afatet për pagesën e donacioneve:** Rishikimi i afatit të përcaktuar përfundimtar për pagesën e donacioneve, përkatësisht duhet të sigurohet që donacionet të paguhen më së voni deri në ditën e përfundimit të fushatës zgjedhore.
- **Rishikimi i nenit 84-b, paragrafi 8:** Rishikimi i nenit 84-b, paragrafi 8, me të cilin do t’i jepet mundësi Ministrisë së Financave, me akt nënligjor, të rregullojë mënyrën e mbajtjes së librave kontabël dhe përgatitjes së raportit financiar për fushatën zgjedhore, duke marrë parasysh të gjitha llojet dhe burimet e financimit të fushatës zgjedhore, veçanërisht në rastet kur ato jo gjithmonë krijojnë të ardhura monetare në llogarinë transaksionale. Njëhërsh, parashihet inkorporimi i raportimit dhe monitorimit plotësisht digjital nga ana e pjesëmarrësve dhe organeve kompetente.
- **Dispozita ndëshkuese dhe kundërvajtëse:** Rishikimi i Kodit Zgjedhor në mënyrë që në pjesën e dënimeve dhe dispozitave kundërvajtëse të parashikohen gjopa edhe për mediat elektronike (portalet e internetit) në rast të mosdorëzimit të raportit për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe për mjetet e paguara ose të kërkuara mbi këtë bazë.
- **Trajnimi dhe mbështetja për raportimin financiar:** Ekziston nevoja për përcaktimin e një organi që do të zhvillojë trajnime lidhur me raportimin financiar, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe informimit në kohë të publikut për financimin e fushatës zgjedhore.

Këto dobësi vënë në dukje nevojën për përmirësime serioze të Kodit Zgjedhor, me qëllim që të sigurohet një rregullim i drejtë, transparent dhe efikas, i cili do t’i mundësojë Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe të gjitha institucioneve të tjera, të zbatojnë në mënyrë efektive kompetencat e tyre dhe të kontribuojnë në integritetin e proceseve zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

8. KONKLUZION

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në përputhje me nenin 36 paragrafin 3 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, hartoi Raport të Veçantë për gjendjet e konstatuara në financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe anëtarëve të këshillave komunalë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, i cili paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të aspekteve financiare të procesit zgjedhor, duke u fokusuar veçanërisht mbi të ardhurat, shpenzimet dhe kornizën ligjore që ka të bëjë me financimin e fushatës zgjedhore.

Raporti i analizon në mënyrë të detajuar edhe procedurat administrative në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore. Ky dokument ofron analizë të hollësishme të rrjedhave financiare, identifikon dobësi sistemike dhe paraqet masa të propozuara për përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit të aktiviteteve zgjedhore, si dhe për forcimin e rolit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në luftën kundër korrupsionit, përmes veprimit efikas në trajtimin e lëndëve dhe zbatimit të masave për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Komisioni tregoi efikasitet dhe vendosmëri në trajtimin e rasteve të parregullsive në lidhje me fushatën zgjedhore. Ky raport thekson rastet konkrete që janë proceduar, të cilat kanë rezultuar me vendosjen e sanksioneve përkatëse dhe ndërmarrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, përmes aktiviteteve të tij, forcoi rolin e vet si autoritet mbikëqyrës dhe kontribuoi ndjeshëm në rritjen e besimit në procesin zgjedhor. Çdo procedurë u zhvillua në mënyrë transparente, duke siguruar llogaridhënie dhe përgjegjësi më të madhe nga aktorët politikë. Kjo vë në dukje përparimin e KSHPK-së në krijimin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe me integritet, duke reduktuar rreziqet nga aktivitetet korruptive.

Me këtë raport i kemi përfshirë aktivitetet që i ndërmerr KSHPK-ja para fillimit të fushatës zgjedhore, si masa parandaluese përmes publikimit të njoftimeve për kufizimet ligjore sa i përket shpenzimit të mjeteve buxhetore, me qëllim zvogëlimin e aktiviteteve të paligjshme gjatë procesit zgjedhor. Së këtejmi, me analizën e të gjitha kërkesave për të siguruar opinionin konstatuam se ato më së shpeshti lidhen me çështje nga fusha e punësimeve, avancimeve, zhvillimit të procedurave disiplinore, fillimit të ndërtimit të objekteve, tjetërsimit të pronës dhe aktiviteteve të ngjashme gjatë periudhës zgjedhore, si dhe se kërkuarit më të shpeshtë të opinionëve janë ministritë, komunat dhe institucionet shtetërore/publike, gjë që tregon nevojën për saktësimin e mëtejshëm të ndalimeve të përcaktuara me nenin 8-a dhe nenin 8-b të Kodit Zgjedhor dhe nenin 34 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit gjatë procesit zgjedhor, me qëllim shmangien e rrezikut të veprimeve të paligjshme dhe shpenzimit të paligjshëm të mjeteve buxhetore.

Sa i përket detyrimit ligjor për dorëzimin e të dhënave për automjetet zyrtare me të cilat disponojnë institucionet, u konstatua një nivel i ulët (42%) i përmbushjes së këtij detyrimi, si dhe mungesë të një zgjidhjeje normative për sanksionimin nga ana e KSHPK-së, gjë që e redukton mundësinë për parandalimin e keqpërdorimit të automjeteve zyrtare për nevojat e fushatës zgjedhore. Në drejtim të rritjes së transparencës, Komisioni publikisht i shpalli të gjitha institucionet që nuk dorëzuan informacione brenda afatit ligjor.

Nga burimet e përgjithshme për financimin e fushatës zgjedhore në shumën prej 595.017.106 denarë, 48% janë mjete të siguruar drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit për reklamim politik të paguar. Për këtë arsye, KSHPK-ja e thekson nevojën për ndryshimin e rregullimit ligjor në drejtim të rishikimit të këtij modeli të financimit të fushatave zgjedhore, për shkak të rreziqeve korruptive dhe ndikimit të mundshëm të partive politike në politikën editoriale të mediave.

Sa i përket veprimit ndaj lëndëve për këtë proces zgjedhor, KSHPK-ja formoi gjithsej 43 lëndë, nga të cilat 42 mbi bazën e denoncime me dyshime për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit gjatë periudhës zgjedhore, dhe 1 lëndë me vetë iniciativë, sipas zërit të ndërgjuar nga mediat.

KSHPK-ja veprimi mbi gjithsej 38 (tridhjetë e tetë) lëndë, nga të cilat në 33 (tridhjetë e tre) lëndë është marrë vendim për ndërprerjen e procedurës, ndërsa në 3 (tri) lëndë është marrë vendim për hedhjen poshtë të denoncimit. Për një lëndë është konkluduar bashkimi me një lëndë tjetër me pretendime të njëjta ose të ngjashme, ndërsa për një lëndë tjetër është konkluduar rishpërndarje dhe veprim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Denoncuesve.

Gjatë veprimit të KSHPK-së sipas denoncimeve të paraqitura, në një lëndë është konstatuar shkelje e dispozitave të nenit 36 paragrafit (1) të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe të nenit 8-b të Kodit Zgjedhor, për shkak të dyshimit për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga drejtori i një ndërmarrjeje publike, i cili kishte mundësuar përdorimin e autobusëve në pronësi të ndërmarrjes për reklamim politik, në kundërshtim me dispozitat e specifikuar ligjore. Për këtë arsye, KSHPK-ja ka paraqitur iniciativë për ndjekje penale në Prokurorinë Publike të RMV-së kundër drejtorit të ndërmarrjes publike.

Sa i përket detyrimit ligjor për dorëzimin e raporteve, u konstatua se 54% e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor nuk e kanë dorëzuar raportin e përgjithshëm financiar, ndërsa një numër shumë i vogël i personave juridikë që realizojnë reklamim politik të paguar kanë dorëzuar raporte në KSHPK. Kjo e cenon parimin e transparencës së fushatës zgjedhore dhe e ul besimin në të gjithë procesin zgjedhor, për çka nuk janë shqiptuar sanksione nga institucionet kompetente.

KSHPK-ja kontribuon dukshëm në mbrojtjen e ligjshmërisë, objektivitetit dhe transparencës së procesit zgjedhor, përmes monitorimit dhe kontrollit efikas të financimit, aktiviteteve parandaluese dhe menaxhimit të denoncimeve për parregullsi. Është e nevojshme të vazhdohet me përmirësimin e mekanizmave për pluftimin e parregullsive zgjedhore dhe të stimulohet ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në zbulimin e aktiviteteve korruptive, gjë që është thelbësore për ruajtjen e proceseve demokratike dhe besimit të qytetarëve në institucionet.

Raporti identifikon një numër të madh mangësish në kornizën ligjore dhe administrative që e rregullojnë procesin zgjedhor dhe financimin e fushatave zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Krahas ekzistencës së rregullimit ligjor, problemet e konsiderueshme në zbatimin e tij krijojnë rrezik për korrupsion. Kjo është veçanërisht e theksuar në zbatimin jo të duhur të dispozitave ligjore, gjë që çon në rritjen e rrezikut për keqpërdorimin e mjeteve. Procedurat administrative, siç është raportimi i donacioneve dhe shpenzimeve nga partitë politike, janë vlerësuar si tepër komplekse dhe joefikase, gjë që çon në rritjen e kostove administrative dhe vonesa. Nevojitet reformë e këtyre proceseve për të arritur efikasitet më të madh dhe për të reduktuar mundësitë për korrupsion.

Raporti vë në dukje nevojën për forcimin e sistemeve të monitorimit dhe mbikëqyrjes për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në financimin e fushatave zgjedhore. Menaxhimi financiar paraqet një sfidë serioze, por suksesi i KSHPK-së në luftën kundër korrupsionit dhe ballafaqimin me parregullsitë është i dukshëm dhe i rëndësishëm, pavarësisht të gjitha sfidave.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit rekomandon inkorporimin e mekanizmave të rinj për monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe riorganizimin e proceseve administrative për menaxhim më efikas të burimeve dhe për reduktimin e mundësive për korrupsion.

Ky raport është një dokument i rëndësishëm që ofron një pasqyrë të qartë të gjendjes së financimit të fushatave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut në vitin 2025. Përmes shqyrtimit të detajuar të të ardhurave, shpenzimeve dhe kornizës ligjore, raporti e apostrofon nevojën për reforma dhe përmirësime që do të sigurojnë një proces zgjedhor të drejtë dhe transparent në të ardhmen.

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit „**Institucione rezistente për qeverisje demokratike dhe zgjedhje në Ballkan**“, i financuar nga **Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar**, me mbështetjen e **Ambasadës Britanike në Shkup**, si dhe nga **Programi për Mbështetjen e Zgjedhjeve i Bashkëpunimit Zvicëran në Maqedoninë e Veriut**, i zbatuar nga **Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES)**. Përmbajtja e këtij produkti nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve, projekteve apo zbatuesit(ve).

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
1	Koalicioni i udhëhequr nga LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË – LSDM	300000005356085	✓	✓	✓	✓	✓	✓
2	Koalicioni i udhëhequr nga LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË – LSDM	300000005356182	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	Koalicioni i udhëhequr nga LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË – LSDM	300000005356473	✓	✓	✓	✓	✓	✓
4	Koalicioni i udhëhequr nga LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË – LSDM	300000005356570	✓	✓	✓	✓	✓	✓
5	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296960021	✓	✓	✗	✗	✓	✓
6	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296956820	✓	✓	✓	✓	✓	✓
7	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296977287	✓	✓	✗	✗	✓	✓
8	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296984077	✓	✓	✗	✓	✓	✓
9	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296982040	✓	✓	✗	✓	✓	✓
10	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004297005514	✓	✓	✓	✓	✓	✓
11	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296953134	✓	✓	✗	✓	✓	✓
12	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004297006096	✓	✓	✗	✓	✓	✓
13	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296962058	✓	✓	✗	✓	✓	✓
14	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296976705	✓	✓	✓	✓	✓	✓
15	Koalicioni “MAQEDONIA JOTE” i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	200004296957305	✓	✓	✗	✓	✓	✓
16	ALEANCA KOMBËTARE PËR INTEGRIM - AKI	280101105786966	✓	✓	✓	✗	✓	✓
17	Koalicioni për një të ardhme të gjelbër	300000005358704	✓	✓	✓	✗	✓	nuk ka ekstrakte
18	Koalicioni PËRVOJË PËR SUKSES i udhëhequr nga Partia Liberal-Demokrate	300000005359286	✓	✓	✓	✗	✓	✓
19	Koalicioni VLEN	200004295561281	✓	✓	✓	✓	✓	✓
20	PARTIA POLITIKE LEVICA	300000005350944	✓	✓	✓	✓	✓	✓

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
21	Edinstvena Makedonija	320100033698868	✓	✓	✗	✓	✓	✓
22	Partia Politike TMRO	280116103763036	✓	✓	✓	✓	✓	✓
23	Partia Politike DEMOKRATËT Shkup	300000005352787	✓	✓	✗	✗	✓	✓
24	Lëvizja ZNAM PËR MAQEDONINË TONË	300000005357249	✓	✓	✓	✗	✓	✓
25	Aksioni Maqedonas – MAAK	320100033707404	✗	✗	✗	✗	✓	✓
26	Partia e Pensionistëve	300000005358316	✓	✓	✗	✗	✓	✓
27	Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë	300000005355406	✓	✓	✗	✗	✓	✓
28	Partia Politike “Iniciativa Qytetare” – GRIN	270078688550183	✓	✓	✗	✓	✓	✓
29	VMRO – Partia Popullore	200004293435041	✓	✓	✓	✓	✓	✓
30	Partia Politike Lëvizja për Unitetin Kombëtar të Turqve	270078644000120	✓	✗	✓	✗	✓	✓
31	Lidhja Demokratike Boshnjake	270078687820161	✗	✗	✗	✗	✗	✓
32	PARTIA PUNËTORE	300000005357540	✓	✓	✗	✗	✓	✓
33	Era e Tretë Maqedonase / Listat e Pavarura Maqedonase – Sovranistët – Mirjana Mirchevski	270078656860186	✓	✓	✓	✗	✗	✓
34	Partia Politike LËVIZJA PËR UNITET KOMBËTAR TË TURQVE	210078688980177	✓	✗	✓	✗	✓	nuk ka ekstrakte
35	Partia Jote Shkup – Fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale 2025	300000005356667	✓	✓	✓	✓	✓	✓
36	KONCEPTI MAQEDONAS	30000 0005357928	✓	✓	✗	✗	✓	✓
37	Partia e Demokratëve të Bashkuar – PODEM	200004296711507	✓	✓	✓	✓	✗	✓
38	ALEANCA DEMOKRATIKE	300000005356958	✓	✓	✓	✗	✓	✓
39	Partia Politike RODINA MAQEDONIA – Zgjedhjet Lokale 2025	270078691770195	✓	✓	✓	✗	✓	✓
40	Partia / Forcat Demokratike të Romëve	300000005358510	✓	✗	✗	✗	✗	✓

Burimi: Të dhëna administrative nga KSHPK nga raportet e përgjithshme financiare

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
41	Partia / Lidhja e Romëve	300000005357831	✗	✓	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
42	Partia / Unioni i Romëve	300000005351138	✗	✓	✓	✗	✓	✓
43	Partia / Partia Demokratike e Romëve	200004296710052	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
44	Partia Politike Desnica	210078704420152	✓	✓	✗	✓	✓	nuk ka ekstrakte
45	Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni - Bratska	300000005352302	✓	✗	✓	✓	✗	✓
46	Partia Politike "Partia Serbe në Maqedoni"	210078701240104	✓	✓	✓	✗	✓	✓
47	Partia Politike Ripërtëritja Demokratike për Maqedoninë	300000005357637	✓	✓	✓	✓	✓	✓
48	Grupi i votuesve Sashe Donev	200004297437455	✓	✗	✗	✗	✓	✓
49	Grupi i votuesve Zoran Todorov	300050000204364	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka saldo o
50	Grupi i votuesve Venko Krstevski	210078663480138	✓	✓	✗	✗	✓	✓
51	Grupi i votuesve Sane Jovanov	300050000204655	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
52	Grupi i votuesve Vane Cekov	290000002784630	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
53	Grupi i votuesve – MIRAN MITREVSKI	300320000044640	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
54	Grupi i votuesve – SLOBODAN VELINOVSKI	300320000044834	✓	✓	✓	✗	✓	nuk ka ekstrakte
55	Grupi i votuesve Gordan Stoshevikj	270078674500121	✗	✗	✗	✗	✓	nuk ka ekstrakte
56	Grupi i votuesve Raman Demirov	320100033708762	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
57	Grupi i votuesve Enis Demirov	250000802743496	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
58	Grupi i votuesve Blagica Sabovljevikj Stoimenova	200004296939554	✗	✓	✗	✗	✗	✓
59	Grupi i votuesve Vlatko Zdravkov	300050000204461	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
60	Grupi i pavarur i votuesve Akji Akiov	250000802744854	✗	✗	✗	✓	✓	✓

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
61	Grupi i votuesve Grozde Mitrov	20000429552357	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
62	Grupi i votuesve Jovica Stoimenov	200004296712089	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
63	GGrupi i votuesve – JAVORKA SOKOLOVSKA	300320000044737	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
64	Grupi i votuesve – ZLATE ALEKSOVSKI	300320000044931	✓	✓	✗	✓	✓	nuk ka ekstrakte
65	Grupi i votuesve Suzana Jovanovska-Ilieva	240310121271596	✓	✓	✗	✓	✓	nuk ka ekstrakte
66	Grupi i votuesve Aleksandar Gligorov	210078662590163	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
67	Grupi i votuesve Slobodan Danevski	30018000025344	✓	✗	✗	✗	✓	nuk ka ekstrakte
68	Grupi i votuesve – GABRIELA ILIEVSKA	210078653410180	✓	✓	✓	✗	✗	✓
69	Grupi i votuesve – VASKO DELOVSKI	210078672630148	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
70	Grupi i votuesve – ZORAN NIKOLOVSKI	270078670850108	✗	✗	✗	✗	✗	✓
71	Grupi i votuesve – RAMADAN IMERI	300170000051195	✗	✗	✗	✗	✗	✓
72	Grupi i votuesve DIMCHE ANDRESKI	280111104138790	✗	✗	✗	✗	✓	✓
73	Grupi i votuesve – kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Debrcës, Zoran Nogacheski – Zgjedhjet lokale 2025, Debrçë	28111104140148	✓	✓	✗	✗	✓	✓
74	Grupi i votuesve DRAGAN SHULEVSKI	500000001548244	✗	✗	✗	✗	✗	✓
75	Grupi i votuesve Marjanche Stojanovski	210078682430155	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
76	Grupi i votuesve Oliver Ivanovski	300290000002592	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
77	Grupi i votuesve ABDULA BAJRAMOSKI	210078685960179	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
78	Grupi i votuesve Milosim Vojneski	300280000054633	✓	✗	✓	✓	✓	nuk ka ekstrakte
79	Grupi i votuesve – Lupcho Stojanovski	270078671230154	✗	✗	✗	✗	✗	✓
80	Grupi i votuesve – Goran Talevski	200004296328357	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
81	Grupi i votuesve – Nasto Palioski	210078666230185	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
82	Grupi i votuesve – MENDI KJURA	270078668600193	✓	✓	✓	✗	✓	✓
83	Grupi i votuesve – Igor Maleski	290000002784242	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
84	Grupi i votuesve – Mirko Saveski	240230121233600	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
85	Grupi i votuesve – Besnik Asani	270078678240150	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
86	Grupi i votuesve Ljupcho Dunimagloski	300020000652360	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
87	Grupi i votuesve Gjorgjija Igeski	200004294491468	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
88	Grupi i votuesve Borche Chupetreski	300020000652457	✓	✓	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
89	Grupi i votuesve Pavlinche Mateska	300020000652845	✗	✗	✗	✗	✓	nuk ka ekstrakte
90	GV Goce Cvetkoski	320100033696443	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
91	Grupi i votuesve Sasho Pivkovski	300060000220611	✗	✗	✗	✗	✗	✓
92	Igor Mitrevski	250000802744078	✓	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
93	Grupi i votuesve – Mile Trajkovski	210078656190103	✓	✓	✓	✓	✗	✓
94	Grupi i votuesve – Zoran Lazrovski – Paljo	290000002780944	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
95	Grupi i votuesve – PETAR KOTEVSKI	380071795300114	✗	✗	✗	✗	✗	✓
96	Grupi i votuesve Drgim Kaja – bartës i listës	300170000051098	✗	✗	✗	✗	✗	✓
97	Grupi i votuesve Janeski Tane – bartës i listës për anëtarë të Këshillit të Komunës së Debrçës – Zgjedhjet lokale 2025 për Komunën e Debrçës	280111104139760	✗	✗	✗	✗	✗	✓
98	Grupi i votuesve BORO GJOREVSKI	300290000002689	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
99	Grupi i votuesve RAIM KERA	210078671580123	✗	✗	✗	✗	✗	✓
100	Grupi i votuesve SAFET REDZOSKI	280110104417214	✗	✗	✗	✗	✗	✓

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
101	GV Nikolina Veljanoska	300280000054924	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
102	GV Nenad Mitreski	300280000054730	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
103	GV Ivica Avramoski	300280000054827	✗	✗	✗	✗	✓	nuk ka ekstrakte ✓
104	GV Violeta P. Smileski	300280000055118	✗	✗	✗	✗	✗	
105	GV Marjan Alampioski	300280000055021	✗	✗	✗	✗	✗	
106	Grupi i votuesve – Burimi Nasufi	210078687660104	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
107	Grupi i votuesve – Alija Kjazimi	270278678590126	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte ✓
108	Grupi i votuesve – Anela Kjazimoski	300160000044066	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka saldo 0
109	Grupi i votuesve Strasho Naumoski	300020000652748	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
110	Grupi i votuesve Vancho Spirkoski	270078664290192	✗	✗	✗	✗	✗	
111	GV Danijel Stojanovski	200004297436970	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
112	GV Arben Dalipi	270079677940129	✗	✗	✗	✗	✓	nuk ka ekstrakte
113	GV Marija Mladenovska	200004296519156	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
114	GV Rushan Hoda	270078697540143	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
115	Grupi i votuesve Zlatko Shurbevski	290000002780459	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte ✓
116	Grupi i votuesve Kire Avtarovski	200004295118379						nuk ka ekstrakte
117	Grupi i votuesve Bobi Boshevski	200004296098467						nuk ka ekstrakte
118	Grupi i votuesve – Vasko Tomulevski	500000001549020						nuk ka ekstrakte
119	Grupi i votuesve – BLAZHE DIMITRIEV	270078678670151						nuk ka ekstrakte
120	Grupi i votuesve – ZORAN PETROV	200004295841417						

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
121	Grupi i votuesve – STIVEN PETKOVSKI	200004296103026	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
122	Grupi i votuesve – kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Strumicës, Dragan Koturovikj	200004295533054	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
123	Grupi i votuesve GJORGI TANUSHEV	200004295966450	✓	✓	✓	✗	✓	nuk ka ekstrakte
124	Grupi i votuesve RISTO SAKALIEV	320100033708665	✓	✓	✗	✗	✗	✓
125	Grupi i votuesve PANCHO MINOV	300040000211009	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka saldo o
126	Grupi i votuesve JOVAN ZLATEVSKI	270078677430103	✓	✓	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
127	Grupi i votuesve Stojancho Velkov	200004295745290	✓	✓	✓	✗	✓	✓
128	Grupi i votuesve Branko Prodanovski	200004296270933	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
129	Grupi i votuesve IGOR AGOVSKI	210078673790171	✓	✓	✗	✗	✓	nuk ka ekstrakte
130	Grupi i votuesve DANIELA STOJKOVIKJ	300000005357734	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
131	Grupi i votuesve NEVENA GEORGIEVSKA	270078657240135	✓	✗	✗	✗	✓	nuk ka ekstrakte
132	Grupi i votuesve Ognen Dedikj	300000005347840	✓	✓	✓	✗	✓	nuk ka ekstrakte
133	Grupi i votuesve TATJANA CHAKULEV	270078657320160	✓	✓	✗	✗	✗	✓
134	Keti Staleska	270078684720138	✓	✓	✗	✗	✓	✓
135	Marko Tashkov	200004296321567	✓	✓	✗	✗	✗	✓
136	Grupi i votuesve Mitko Jakimovski	300000005355309	✗	✗	✗	✗	✗	✓
137	Grupi i votuesve Biljana Ivanovska	300000005361517	✓	✓	✓	✗	✓	✓
138	Grupi i votuesve Goran Gjurovski	300000005362778	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
139	Grupi i votuesve Jane Dimeski	300000005361420	✓	✓	✗	✗	✗	✓
140	Grupi i votuesve Dejan Dimitrovski	210078693710188	✓	✓	✗	✗	✓	✓

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
141	Grupi i votuesve – kandidat i pavarur Azem Sadiki	270078686420160	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
142	Grupi i votuesve – bartës i listës së pavarur – Ibrahim Jusufovski	270078684990186	✓	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
143	Grupi i votuesve ADNAN OSMANOVIKJ	300000005361323	✗	✗	✗	✗	✗	✓
144	Grupi i votuesve MARJAN KALEVSKI	300000005363166	✓	✓	✗	✗	✓	✓
145	Grupi i votuesve Jana Belcheva Andreevska (Të Pavarurit Së Bashku)	300000005362002	✓	✓	✓	✗	✗	✓
146	Grupi i votuesve Dragan Nikolovski	500000001549117	✓	✓	✓	✓	✗	nuk ka ekstrakte
147	Grupi i votuesve Sasho Manevski	300000005354921	✓	✗	✗	✗	✓	✓
148	Grupi i votuesve GORAN MARKOVSKI	300000005361905	✓	✓	✓	✗	✓	✓
149	Grupi i votuesve – Fekri Bakiu	270078687310135	✗	✗	✗	✗	✗	✓
150	Grupi i votuesve VISAR ADEMI	200004294031203	✗	✗	✗	✗	✗	✓
151	Grupi i votuesve SHKODRAN ALILI	270078672550130	✗	✗	✗	✗	✗	✓
152	Grupi i votuesve – Goran Stojkovski-Diro	300090000185932	✓	✓	✗	✗	✓	✓
153	Grupi i votuesve Mesut Bajrami – Për Shqiptarët e Kumanovës	320100033714388	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
154	Grupi i votuesve – Ivan Petkovski	300090000186029	✓	✗	✗	✗	✓	✓
155	Grupi i votuesve Agron Arifi	200004296268896	✓	✓	✗	✓	✓	nuk ka ekstrakte
156	Grupi i votuesve – Kostadin Ristomanov	200004295969069	✗	✗	✗	✗	✗	✓
157	Grupi i votuesve – David Zlatanov	300030000297485	✗	✗	✗	✗	✗	✓
158	Grupi i votuesve Strahil Gavritov	210078694440113	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
159	Grupi i votuesve Të Pavarurit – Ile Bachanov	300020000652651	✓	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
160	Grupi i votuesve Kujtim Kasami	270078673440105	✗	✓	✗	✓	✗	nuk ka ekstrakte

SHTOJCA 1: Statusi i raporteve të dorëzuara/të padorëzuara sipas periudhës së dorëzimit

Numri rendor	Emri i pjesëmarrësit	Llogaria bankare	Dita 11	1 ditë pas përfundimit të raundit të parë	1 ditë para raundit të dytë	1 ditë pasi llogaria të jetë mbyllur	Raporti total	Llogari e mbyllur
161	Grupi i votuesve Petkovski Zoran – Të Pavarurit për Staro Nagorichane	300090000185544	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
162	Grupi i votuesve Dalibor Serafimovikj	300090000186223	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
163	Grupi i votuesve MAGDALENA KARKALASHEVA	320100033722730	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
164	Grupi i votuesve – REMZI MAMUTI	300000005358607	✗	✗	✗	✗	✗	✓
165	Vlatko Smokovski	300000005355018	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka saldo o
166	Group of Voters Ivan Stanoev	200004296500823	✗	✗	✗	✗	✗	nuk ka ekstrakte
167	SUAD ADILOVIKJ	210078692660260	✓	✓	✗	✗	✗	Nuk kemi qasje
168	Limba Minova Zlateski	300040000211979	✗	✗	✗	✗	✓	✓



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Republika e Maqedonisë së Veriut



Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 12/19), si dhe nenit 41-a, paragrafi 8, të Rregullores së punës nr. 02-3794/1, datë 08.08.2019, nr. 03-2198/1, datë 12.06.2020, nr. 02-8774/1, datë 17.10.2022 dhe nr. 02-3087/1, datë 06.12.2024, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në mbledhjen e -të të mbajtur më __.10.2025, miratoi si më poshtë:

RAPORT

për kontroll kundërkorrupsion të dispozitave të
Kodit Zgjedhor, Kapitulli VI – Fushata zgjedhore, me nën-titull
„Përfaqësimi mediatik“, nga neni 75 deri në nenin 76-d

Titulli i ligjit:

- Kodi Zgjedhor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 40/06, 136/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 98/19, 42/20, 74/21, 215/21, 58/24, 76/24).

Me iniciativë të vetë: Në bazë të nenit 17, pika 2 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, dhe në lidhje me ankesën e dorëzuar nr. 03-2594/1 të datës 25.09.2025, në të cilën janë shprehur vërejtje në lidhje me draftin e Udhëzuesit për radiodifuzerët për zgjedhjet lokale 2025, Komisioni Shtetëror, në kolegiumin e mbajtur më 30.09.2025, vendosi me iniciativë të vet të kryhet kontroll kundërkorrupsion të dispozitave të Kodit Zgjedhor, Kapitulli VI – Fushata zgjedhore, me nën-titull „Përfaqësimi mediatik“, nga neni 75 deri në nenin 76-d.

Fusha: procesi zgjedhor

Vlerësimi i përgjithshëm

1. Shqyrtimi i kërkesës:

Me Kodin Zgjedhor rregullohen mënyra, kushtet dhe procedurat për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë, për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit, për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit, për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të të drejtës së votës, për mbajtjen e Listës së Votuesve, për përcaktimin e kufijve të njësive zgjedhore, si dhe për përcaktimin e vendvotimeve dhe kushtet për funksionimin e tyre.

2. Materialet shtesë të shqyrtuara / konsultuara:

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 12/2019);

- Udhëzues për radiodifuzerët për zgjedhjet lokale 2025, nr. 01-4137/1, datë 26.09.2025;
- Ligji për shërbimet audio dhe audiovizuale mediatike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24).

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në bazë të nenit 17, pika 2 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, dhe në përputhje me Metodologjinë për kontrollin kundërkorrupsion të legjislacionit, nr. 03-4058/1, datë 27.11.2020, ka kryer kontroll kundërkorrupsion të dispozitave të përmendura, pas së cilës e miratoi si më poshtë:

PËRFUNDIM

Pas analizës së realizuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor, Kapitulli VI – Fushata zgjedhore, me nën-titull „Përfaqësimi mediatik“, nga neni 75 deri në nenin 76-d, Komisioni Shtetëror hasi në ekzistencën e rreziqeve rregullatore.

Arsyetim

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me iniciativë të vetë, vendosi të kryejë kontroll kundërkorrupsion të dispozitave të Kodit Zgjedhor që lidhen me përfaqësimin mediatik, konkretisht: nenet 75, 75-a, 75-b, 75-v, 75-g, 75-gj, 76, 76-a, 76-b, 76-v, 76-g dhe 76-d, për të cilat u formua një lëndë në Njësinë për kontroll kundërkorrupsion të legjislacionit.

Me qëllim të konsistencës dhe gjithëpërfshirjes së dispozitave të analizuar, u morën parasysh edhe dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor që korrespondojnë me nenet 75 deri në 76-d.

Gjatë kontrollit të këtyre dispozitave, Komisioni Shtetëror identifikoi rreziqe nga korrupsioni në dispozitat e nenit 75-gj të Kodit Zgjedhor.

1. Me **nenin 75-gj, paragrafi (1)** të Kodit Zgjedhor rregullohet:

“Gjatë fushatës zgjedhore dhe në rrethin e parë dhe të dytë të votimit, radiodifuzerët të cilët i mbulojnë zgjedhjet mund të emitojnë gjithsej nëntë minuta e tridhjetë sekonda kohë shtesë, për reklamim në program të emituar për orë reale, që është e dedikuar për reklamim të paguar politik, nga të cilat për dy partitë më të mëdha politike të pozitës, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më të shumti vota, mund të ndajnë më së shumti katër minuta, të cilat ndahen me marrëveshje paraprake me shkrim, për dy partitë më të mëdha politike në opozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më së shumti vota mund të ndajnë më së shumti katër minuta, të cilat ndahen me marrëveshje paraprake me shkrim, për partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë fituar mjaftueshëm deputetë për të formuar grup deputetësh mund të ndajnë një minutë e cila ndahet me

marrëveshje paraprake me shkrim dhe për partitë politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ose kandidatët mund të ndajnë tridhjetë sekonda të cilat ndahen me marrëveshje paraprake me shkrim”.

Gjatë analizës së dispozitës së nenit 75-gj, paragrafi (1), Komisioni Shtetëror konstatoi ekzistencën e rreziqeve rregullatore për shkak të dykuptimisë në formulimin ligjor dhe mungesës së saktësisë së përmbajtjes normative, gjë që, sipas Metodologjisë për kontrollin kundërkorrupsion të legjislacionit, mund të krijojë kushte për pasiguri juridike dhe zbatim jo të njëjtë.

Konkretisht, nga kontrolli kundërkorrupsion i dispozitës së përmendur, e cila rregullon kohën dhe mënyrën e transmetimit të programeve të dedikuara ekskluzivisht për reklamim politik të paguar nga radiodifuzerët që mbulojnë zgjedhjet gjatë fushatës zgjedhore, janë konstatuar rreziqet e mëposhtme rregullatore:

1.1) Rreziku i parë rregullator

Legjislatori, në përcaktimin e dispozitës, përdor fjalë si “mund” dhe “më së shumti”, të cilat, në kontekstin e fjalëve të tjera të përdorura, lënë hapësirë për interpretime të ndryshme. Kështu, fjala “mund”, e përdorur në dispozitë, sipas kuptimit të vet, nuk nënkupton dhe nuk tregon obligativitet, për të cilën arsye gjatë zbatimit të ligjit mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Ky formulim nuk përmban një udhëzim të qartë imperativ dhe nga kjo mund të rezultojë në interpretime të ndryshme në praktikë, veçanërisht kur bëhet fjalë për qasje të barabartë të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore në hapësirën mediatike.

Po ashtu, një interpretim i ndryshëm gjatë zbatimit praktik të dispozitës mund të shkaktohet edhe nga fjalët “më së shumti katër minuta”, sepse përdorimi i tyre tregon se legjislatori ka përcaktuar kufirin e sipërm të kohës për reklamim politik të paguar, i cili nuk duhet të tejkalohet, por nuk ka përcaktuar kufirin e poshtëm të kohës për këtë reklamim.

Për shkak të të lartpërmendurave, Komisioni Shtetëror konstatoi se zgjedhja e fjalëve dhe mënyra se si janë lidhur, gjegjësisht konstrukti i fjalisë në dispozitën e përmendur, përmban teknikë ligjore-juridike të pakohërentë dhe është dykuptimshme, duke lënë hapësirë që disa subjekte që zbatojnë ligjin ta interpretojnë në mënyra të ndryshme, dhe për pasojë ta zbatojnë në mënyra të ndryshme në situata të caktuara.

1.2) Rreziku i dytë rregullator

Për më tepër, rreziku rregullator i përmendur më sipër, sipas Komisionit Shtetëror, është në lidhje të drejtpërdrejtë shkak-pasojë me një tjetër rrezik rregullator, i cili shfaqet për shkak të mbulimit të paplotë të të gjitha aspekteve të rregullativës ligjore, gjegjësisht, mospërfshirjes së të gjithë pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, për të cilët radiodifuzerët do të transmetojnë program të dedikuar ekskluzivisht për reklamim politik të paguar gjatë fushatës zgjedhore.

Konkretisht, legjislatori në Fjalorin e ligjit, në nenin 2, pika 14, 24, 26 dhe 28, ka përdorur një shtrirje të gjerë në përcaktimin e kuptimit të termave, siç janë:

14. “Pjesëmarrësi i fushatës zgjedhore” është personi i autorizuar nga partia politike,

koalicioni ose një grup zgjedhësish që e organizojnë fushatën zgjedhore;

24. “Qasje e drejtpërdrejtë te zgjedhësit” janë format e prezantimit falas politik dhe të reklamimit të paguar politik, përmes të cilave pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore lirshëm i promovojnë programet, qëndrimet dhe kandidatët e vet;

26. “Reklamim i paguar politik” është qasja e drejtpërdrejtë e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore te zgjedhësit, përmes së cilës lirshëm me kompensim në para promovohen programet zgjedhore, qëndrimet dhe kandidatët,;

28. “Prezantim zgjedhor mediatik” është promovimi (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i qëndrimeve, programeve, platformave, arritjeve, aktiviteteve etj, të partive politike, koalicioneve, grupeve të zgjedhësve dhe përfaqësuesve të tyre.

Nga ana tjetër, gjatë përcaktimit të nenit 75-gj, paragrafi (1), legjislatori ka përdorur një qasje të ndryshme, duke listuar pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, siç janë:

- “**dy partitë më të mëdha politike të pozitës, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më së shumti vota**”
- “**dy partitë më të mëdha politike në opozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më së shumti vota**”
- “**për partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë fituar mjaftueshëm deputetë për të formuar grup deputetësh**” dhe
- “**për partitë politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ose kandidatët**”.

Mënyra e tillë e rregullimit, e përdorur në dispozitën e nenit 75-gj, paragrafi (1), lë mundësi që gjatë zbatimit të saj të shfaqen raste të papritura nëse në fushatën zgjedhore shfaqen parti që nuk përfshihen nga kjo dispozitë, edhe pse ato i përmbushin kushtet sipas ligjit dhe kanë të drejtë të paraqiten si pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, në përputhje me fjalorin në nenin 2 të Kodit Zgjedhor. Nga këtu, nëse merret parasysh rreziku i parë rregullator në pikën 1.1), i cili paraqitet për shkak të zgjedhjes së fjalëve, konstruksionit të përdorur të fjalisë dhe teknikës ligjore-juridike të pakoherentë, si dhe rreziku i dytë rregullator nga nën-pika 1.2), për shkak të mbulimit të paplotë ligjor në nenin 75-gj, paragrafi (1) për të gjithë pjesëmarrësit që mund të paraqiten në fushatën zgjedhore, del se ekziston boshllëk ligjor për shkak të paqartësisë së dispozitës, ku këta dy rreziqe rregullatore krijojnë njëkohësisht mundësi për interpretim subjektiv dhe zbatim të ndryshëm.

1.3) Rreziku i tretë rregullator

Më tej, me dispozitën e nenit 75-gj, paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor, legjislatori, në rregullimin e reklamimit politik të paguar, ndër të tjerat ka marrë parasysh “**dy partitë më të mëdha politike të pozitës gjegjësisht të opozitës, të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar numrin më të madh të votave**”.

Njëkohësisht, sipas Fjalorit të këtij ligji, në nenin 2, pika 14, parashikohet se gjatë fushatës zgjedhore, si pjesëmarrës mund të paraqitet edhe një person i autorizuar nga “koalicioni”, si një shoqatë e bazuar në marrëveshjen e dy ose më shumë partive politike të regjistruara për të vepruar së bashku gjatë zhvillimit të zgjedhjeve.

Nëse dispozitat e përmendura vihen në korrelacion, del se legjislatori nuk ka parashikuar kohën për reklamim politik të paguar për koalicionet që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend dhe që kanë fituar numrin më të madh të votave, duke bërë që kjo të mos jetë terminologjikisht dhe thelbësisht e përputhshme me Fjalorin e nenit 2 të këtij ligji.

Nga kjo, sipas Komisionit Shtetëror, në këtë dispozitë lind një rrezik rregullator për shkak të mos-përputhjes së nenit 75-gj, paragrafi (1), me Fjalorin e këtij ligji.

2. Me nenin 75-gj, paragrafi (12), rregullohet:

“Hapësira reklamuarë e mediave elektronike (portaleve të internetit) dhe mediave të shtypit e dedikuar për reklamim të paguar politik, ndahet sipas kritereve në vijim:

- më së shumti 45% e hapësirës reklamuese mund t’u ndahet dy partive më të mëdha politike në pozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më të shumti vota,
- më së shumti 45% e hapësirës reklamuese mund t’u ndahet dy partive më të mëdha politike në opozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më të shumti vota,
- më së shumti 7% e hapësirës reklamuese mund tu jepet partive politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë që në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë marrë mjaftueshëm deputetë për të formuar grup deputetësh dhe
- më së shumti 3% e hapësirës reklamuese mund tu jepet partive politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Gjatë kontrollit kundërkorrupsion të dispozitës së paragrafit (12) të nenit 75-gj, e cila rregullon të drejtën për reklamim politik të paguar në hapësirën reklamuese të mediave elektronike (portale interneti) dhe mediave të shtypura, Komisioni Shtetëror konstatoi të njëjtat rreziqe që u shpjeguan më parë për paragrafi (1) të këtij neni.

3. Me nenin 75-gj, paragrafi (13), rregullohet:

“Radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet e internetit) në Republikën e Maqedonisë kanë për detyrë që të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor t’u sigurojnë qasje të barabartë për reklamim të paguar politik”.

Pas analizës së paragrafit (13) të këtij neni, Komisioni Shtetëror konstatoi ekzistencën e konfliktit të brendshëm të këtij paragrafi me paragrafët (1) dhe (12) të të njëjtit nen, si rrezik rregullator për korrupsion, për shkak se këta paragrafë nuk janë të harmonizuar ndërmjet tyre.

Konkretisht, me dispozitën e paragrafit (13) të këtij neni, legjislatori ka përcaktuar detyrimin për radiodifuzerët, mediat e shtypura dhe mediat elektronike (portalet e internetit) në Republikën e Maqedonisë, që të sigurojnë për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor qasje të barabartë për reklamim politik të paguar, gjë që nga ana tjetër nuk mundësohet nga paragrafët (1) dhe (12) të këtij neni.

4. Duke pasur parasysh rreziqet rregullatore të konstatuara më parë nga aspekti i përfaqësimit mediatik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, Komisioni Shtetëror u ndal edhe te pjesa e dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor që janë në korrelacion me këtë përfaqësim.

Me këtë rast, konstatoi se neni 75-gj, paragrafët (1) dhe (12), nuk janë të harmonizuar edhe me dispozitën e nenit 70, paragrafi (2), me të cilën legjislatori rregullon se: **“Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore** kanë të drejtë për qasje të barabartë dhe në kushte të barabarta t'i shfrytëzojnë të gjitha llojet e propagandës politike, njoftimit dhe format e tjera të propagandës, që ka për qëllim të ndikohet në vendimin e zgjedhësve gjatë votimit..”

Nga kjo dispozitë e formuluar në këtë mënyrë, u konstatua se ekziston një kolizion i brendshëm, përkatësisht mos-harmonizim juridik i nenit 75-gj, paragrafët (1) dhe (12), edhe me nenin 70, paragrafi (2) të këtij ligji.

Përfundime dhe rekomandime

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, gjatë analizës dhe kontrollit të kryer të dispozitave të sipërpërmendura të Kodit Zgjedhor, arriti në përfundimin se është e nevojshme të ndërmerren masa për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, në drejtim të ndryshimit dhe plotësimit, si më poshtë:

- përdorimi i një gjuhe të qartë dhe të padyshimtë gjatë rregullimit të kohës së reklamimit politik të paguar te radiodifuzerët, të përcaktuar në nenin 75-gj, paragrafi (1);
- harmonizimi i dispozitës së nenit 75-gj, paragrafi (1) dhe (12), me nenin 2, pika 14 të Kodit Zgjedhor;
- harmonizimi i nenit 75-gj, paragrafi (1) dhe (12), me paragrafin (13) të të njëjtit nen;
- harmonizimi i nenit 75-gj, paragrafi (1) dhe (12), me nenin 70, paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor.

Me qëllim të minimizimit të rreziqeve rregullatore nga korrupsioni që mund të dalin nga zbatimi i Kodit Zgjedhor, nga aspekti i zbatimit të Metodologjisë për kontrollin kundërkorrupsion të legjislacionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit e paraqet këtë mendim.

Njëkohësisht, theksohet nevoja që ministria kompetente, të paraqesë në kohë njoftim për aktivitetet e ndërmarra në drejtim të tejkalimit të rreziqeve rregullatore të konstatuara, gjegjësisht arsytim për rekomandimet që nuk janë pranuar.